



ALBANIA FUTBOLL

NR. 28 • DHJETOR 2017

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM



SHULKU: "JA STACIONET E STRATEGJIVE NË ZBATIM!"



UEFA
NATIONS
LEAGUE

NJË TJETËR SHANS DREJT EURO 2020!

► FAQE 12-13

GJITHÇKA PER FEMIJËT!

"GRASSROOTS" dhe "GROW", projektet ambicioze dhe të shpejta në mbështetje maksimale për futbollin e fëmijëve, si prioritete absolute të FSHF me moshat

► FAQE 18-19



TETORI
ELEMATOR!

FSHF, TJETËR STANDART NË TRE TURNETË E UEFA-S!

► FAQE 14-15-16

FLET KAPITENI
I EKIPIT KOMBETAR

ANSI AGOLLI:
REZULTATET DO VIJNË, JAM I BINDUR

► FAQE 6-7



EDITORIAL

NGA "GRASSROOTS" TE "GROW", GJITHÇKA PËR FËMIJËT!

Grow" dhe "Grassroots", natyrisht dy etiketime ndërkombëtarisht të lidhur me një mision fisnik, atë që përkon edhe me prioritetin absolut të FSHF-së, futbollin e fëmijëve dhe jo vetëm. Dy projekte, tërësisht nën kurimin e drejtpërdrejtë të FSHF-së dhe që do të shtrijnë kapilarët e tyre në të gjithë Shqipërinë. Për çdo fëmijë, të çdo moshe, drejt një ëndërrë të tyre, për të qenë afër futbollit. Pjesa e futbollit kudo në çdo vend, dhe përtej anës profesioniste është tashmë e nisur. Kemi edhe ambasadorin tonë të Grassroots, ish-kapitenin Lorik Cana, që sërish është pjesë e këtij projekti që do të vazhdojë gjatë. Por, përpos kësaj, shumë shpejt nis një tjetër projekt me suportin e plotë të UEFA dhe FSHF, pikërisht projekti "Grou", për moshat 7 deri në 9 vjeç. Dhe jo vetëm këto, por paralelisht po zbatohet edhe një strategji për të gjithë pjesën amatore, dhe futbollit të femrave. Por, nisët nga shkollat, në orët e atjeshme të Edukimit fizik, për të vijuar më pas në të gjitha hapat e mëtejshëm të futbollit të luajtur. Përtej shumë e shumë drejtimeve të evidentuara edhe në intervistën e Shulkut (e gjeni në këtë numër) FSHF punton fort në prioritetin e saj madhor: Futbollin e fëmijëve, dhe çdo gjë për fëmijët. Dy projekte madhore dhe me të gjitha konturet e standareve, brenda një manuali që garanton çdo gjë në të gjitha aspektet e trajnimit dhe përgatitjes. Muajt që do të pasojnë do të jenë pjesë e një strategjie faktike, vetëm në kurim dhe suport të fëmijëve, aty ku për ta nis ëndërra.



**Gert
ÇARÇANI**

Editor i "ALBANIA FOOTBALL"
BOTIM ZYRTAR I FSHF-së



8-9 **BILANCI I "RUSI 2018"**
DUKA: "VENDI I 3-TË, MËSE POZITIV"



10 **PAS 4 SFIDAVE**
PANUÇI: "ME KURAJO DREJT EURO 2020!"

9 **ULET SIPARI**
ELEMINATORET, JA STATISTIKAT!

29 **MBYLLET FAZA E PARË**
DITËT E AKADEMISË SË ARBITRIMIT!

21 **KATEGORIA SUPERIORE**
FITORET NË TRANSFERTË NË EKUILIBËR!

34 **PROPOZIMI I FSHF**
PAKETË E PLOTË LIGJORE PËR SPORTIN!



37 **IN MEMORIAM**
NJË VIT PA SAFET BERISHËN!

EQUAL GAME



RESPECT



**BOTIM ZYRTAR I
FEDERATES SHQIPTARE
TE FUTBOLLIT**

TEL: +355 423 46601
FAX: +355 423 46609
E-mail: info@fshf.al

Mesazhi

ANGAZHIM MAKSIMAL PËR FUTBOLLIN E FËMIJËVE!

Se zoni i nisur ka përfshirë futbollin në shumë drejtime, si te garat, ekipet kombëtare, turnetë e sapombyllur të UEFA-s, por me një vëmendje të veçantë edhe tek futbollin e fëmijëve, futbollin amator dhe ai i femrave. Jo thjesht me një ndies personale, por edhe si një prioritet absolut i FSHF-së, pjesa e futbollit me fëmijëve ka nisur dhe do të vijojë me një program afatgjatë mbështetjeje absolute. Dhe jo vetëm te fëmijët, por edhe te futbollin e femrave, apo edhe ai amator, tek kushdo luan dhe dëshiron të luajë futboll në çdo vend të Shqipërisë. Të gjithë ata e kanë dhe duhet ta kenë strehën e tyre, e cila është Federata e Futbollit. Dhe për këtë strategjitë konkrete kanë nisur të jenë pjesë faktike e zbatimit. Paralel, projektet "Grassroots" e "Groë" janë një tjetër shtysë e jashtëzakonshme për fëmijët. Një financim dhe mbështetje e drejtpërdrejtë vetëm për ta. Nisim shumë shpejt projektin e përbashkët me Ministrinë e Arsimit, për orët e futbollit mes orëve të Edukimit fizik në shkollat 9-vjeçare. Me anë të këtij projekti, ashtu si edhe në vendet e tjera synohet forcimi i vlerave shoqërore nëpërmjet sportit të bukur të futbollit. Një kurim i gjithanshëm për të vënë në shinat e standarteve të gjithë botën shqiptare të futbollit të fëmijëve mbi trainimin dhe përgatitjen e tyre. Mundësi pafund, dhe hapësira për çdo fëmijë që të jetë afër futbollit, afër projekteve të tilla, si dhe shumë të tjerëve në vijim, për të cilat FSHF do të jetë maksimalisht e angazhuar dhe plotësisht në shërbim të endërrës së fëmijëve.

ARMAND
DUKA

PRESIDENT
I FSHF-së



► **NË FOTO:**
Ilir Shulku,
Sekretar i përgjithshëm i
Federatës të Futbollit Shqiptar

SEKRETARI SHULKU: PRIORITETET AFATGJATA TË FSHF-së!

Intervistoi: **Gert ÇARÇANI**

Zoti Sekretar, një muaj me shumë ngarkesë, kjo nisur nga shumë turne zyrtarë që UEFA i ka besuar Shqipërisë, por edhe projekteve të tjera...

Dhe jo vetëm turnetë zyrtarë. Sidoqoftë më duhet të them që sipërmarrjet tona për organizimin dhe zhvillimin e raundeve eliminatorë të moshave në Shqipëri është një besim shumë i madh i UEFA-s në drejtim të FSHF-së. Dhe një diçka e tillë nuk ka ardhur rastësisht, por nga konkluzionet shumë pozitive që FSHF ka patur në organizimin e turneve të mëparshëm. Mbyllëm edhe turneun e tretë eliminator. Por, nuk janë vetëm këto, pasi një gamë të madhe të eventeve në institucion, por edhe të shumë nismave, apo edhe projekteve që kryesisht kanë fokusin te prioritetet tona si federatë.

Prioritete të cilat ku janë të përqëndruara?

Janë tashmë të shpallura prej kohësh. Futbollit i fëmijëve, futbollit amator, por edhe Akademia e Arbitrimit. Janë stacionet absolute ku FSHF do të ndalet gjatë dhe me strategji përkatëse. Shumë shpejt do të nisim edhe implementimin e

projektit "Grou", edhe kjo e lidhur ngushtë me shumë sektorë, por edhe në vijimësinë e projektit "Grassroots" për fëmijët. Për projektin "Grou" janë afruar edhe disa djem ambiciozë

për të organizuar brenda të gjitha kontureve maksimale profesionale atë që kërkohet. Departamentet përkatëse kanë hartuar edhe strategjitë e tyre të cilat janë shkruirë në një të vetme dhe





gati për zbatim. Nuk do të harroja këtu një projekt shumë ambicioz që mori start në muajin qershor që ishte edhe projekti "TOPI YT", ku për të klubet e të gjitha niveleve u shpërndanë edhe topat falas, që nga Kategoria Superiore, e deri te ekipet amatore të moshave.

E megjithatë, gara vijon, problematika sidoqoftë nuk mungon?

Natyrisht që garat, kampionatet e të gjitha niveleve vijnë sipas kalendarit përkatës, sikundër edhe programi i ekipeve kombëtare. Problematika te garat? Janë të gjitha pjesë e sezonit, dhe të pashmangshme, por e përgjithshme rezultojnë drejt një gare të fortë në Superiore. Kemi shumë fitore në transfertë dhe ky është një indikacion shumë domethënës për një kampionat të fortë.

Shulku, në lidhje me ekipet kombëtare, edhe aty vijon sezoni me takimet miqësore, por edhe sfida të tjera?

Absolutisht. Sektori përkatës në një koordinim të plotë është gjatë gjithë kohës në shërbim të ekipeve kombëtare, takimeve miqësore, por edhe përgatitjes së sfidave zyrtare.

NË FOKUS

- ▶ FUTBOLLI I FËMIJËVE
- ▶ FUTBOLLI AMATOR DHE AI I FEMRAVE
- ▶ AKADEMIJA E ARBITRIMIT
- ▶ LIÇENSIMET DHE INFRASTRUKTURA
- ▶ GARAT DHE EKIPET KOMBËTARE
- ▶ PROJEKTI I TOPAVE
- ▶ NGRITJET E EKIBEVE KOMBËTARE

Më duhet të shtoj këtu që paralelisht janë ngritur edhe ekipet kombëtare të ndërmjetme, U-16, U-18 dhe U-20, me datëlindjet përkatëse, duke planifikuar edhe për këto grupe stërvitore, seleksionimet përkatëse, por edhe miqësore, sikundër ishte një e radhës në Tbilisi e skuadrës kombëtare U-20. Nuk duhet të harrojmë faktin që çdo datë e lirë për kombëtaren A dhe jo vetëm do të shfrytëzohet dhe do të vihet në dispozicion trajnerëve të ekipeve kombëtare për të patur më shumë kohë në dispozicion me

ekipet. Siç jeni në dijeni, sezonin e ardhshëm ekipi kombëtar do të marrë pjesë paralelisht edhe në eliminatoret e Europianit, por edhe në Kupën e Kombeve. Por edhe një risi tjetër, atë të ngritjes së ekipit kombëtar të femrave U-17, duke pasuar kështu me një tjetër projekt për të patur një grup zinxhir të të gjitha moshave edhe për futbollin e femrave.

Ndërkohë që investimet në aspektin e infrastrukturës vijnë të jenë pjesë e një planifikimi në zbatim?

Sikundër e ka shprehur shpesh edhe Presidenti, investimet nuk është se janë frenuar, por duke qenë se jemi në punë e sipër në një kantier madhor për një vepër të mrekullueshme sikundër është "Arena KOMBËTARE" ato janë fokusuar kryesisht në këtë investim. Por investimet nuk është se janë frenuar. FSHF ka ndërhyrë në fushën e Kamzës, në të Lushnjes, dhe në Kuçovë po realizohet mbulimi i tribunës qëndrore. Ndërkohë që kemi planifikuar edhe fushën e Përmetit e cila është tashmë në plan për tu rikonstruktuar për vitin e ardhshëm. Këto edhe të tjera që janë në planifikim e sipër.



FLET KAPITENI I EKIPIT KOMBETAR

AGOLLI:

REZULTATET
DO VIJNË,
JAM I BINDUR

Tashmë prej kohësh je pjesë shumë e rëndësishme e ekipit kombëtar. Si kapiten i skuadrës, si e përkufizon Ansi mbylljen e eliminatoreve të Botërorit për paraqitjen e Shqipërisë?

E përgjithshme mendoj se është pozitive. Kemi zhvilluar një fazë eliminatorësh të mirë duke u renditur në vendin e 3-të, gjë që është një fakt historik për skuadrën tonë kombëtare. Nëse analizojmë çdo ndeshje më vete ka shumë për të analizuar, për të përmirësuar në mënyrë që të rritemi akoma më shumë.

Cili ka qenë momenti më delikat në këto eliminatore, në këto 10 ndeshje?

Nuk mund ta quaj delikat por, humbja me Izraelin në Elbasan nuk ndikoi aspak mirë në anën psikologjike të skuadrës. Ishte rivali ynë i drejtpërdrejtë për të siguruar vendin e 3-të, ndaj ajo humbje na e komplikoi disi rrugën tonë.

A mendon se kishte ardhur një moment që skuadra ishte ende me mendjen te Europiani, dhe ishte e përfshirë në euforinë e një suksesi historik?

Ne përjetuam emocione marramendëse me pjesëmarrjen në European dhe bashkë me ne mendoj edhe çdo tifoz shqiptar. Të mos harrojmë që ishte eksperiencia jonë e parë në një kompeticion madhor ku ekipi kombëtar mori pjesë. Dhe, është mëse normale që tek çdonjëri përfshi edhe ne futbollistët euforia ishte e madhe. Por, kjo eufori solli edhe një pritshmëri shumë të madhe të publikut duke pritur që skuadra kombëtare të kualifikohet edhe për në kupën e botës, deri në atë pikë sa u harruan edhe skuadrat si Spanja e Italia që ne kishim në grup. Për ne, lojtarët e kombëtares ka qenë mjaft e vështirë të luajë pas Europianit, pasi presioni ishte edhe më i madh se sa në European.

Katër ndeshje me trajnerin e ri. Skuadra duket tashmë me afër filozofisë së lojës që kërkon të vendosë treneri Panucci? Ndien ekipi ndryshim mes lojës së bërë dhe tani? Pa hyrë aspak në krahasime

Katër ndeshje nuk janë shumë dhe koha që treneri ka pasur në dispozicion për ti përcjellë skuadrës idetë e tij ka qenë mjaft e vogël, gjithsesi, pas 4 ndeshjeve dhe kundër rivalëve të nivelit të ndryshëm pak a shumë skuadra e ka kuptuar atë çfarë treneri kërkon nga ne, dhe mendoj që në ndeshjen kundër Italisë skuadra iu përgjigj mjaft mirë, e duke zbatuar në fushë detyrat që treneri na dha. Krahasimi më i saktë mendoj se duhet bërë me veten, dhe përveç dy ndeshjeve të para, të cilat ishin më shumë një periudhë njohjeje, në dy ndeshjet e fundit kam bindjen se skuadra ka treguar progres në lojë, edhe pse jemi të ndërgjegjshëm që na duhet akoma shumë punë në



mënyrë që të përmirësohemi akoma edhe më shumë.

Kemi bërë lojë të mirë me spanjën dhe më pas me Italinë. A mendoni se rezultatet do të vijnë, duke vijuar në këtë rrugë me këtë mission për të prodhuar lojë?

Pa diskutim që pa lojë të mirë kurrsesi nuk ke se si të marrësh rezultate të mira, ndaj për ne e rëndësishme në këtë periudhë është që të harmonizohemi sa më shumë në lojë, në atë çfarë treneri na kërkon. Dhe, duke u rritur sa më shumë në lojë, edhe rezultatet e mira do të vijnë. Mendoj se skuadra është në rrugën e duhur dhe unë personalisht jam shumë optimist me të ardhmen e skuadrës.

Për eliminatoret e Botërorit ishte thujse një pamundësi. Sidoqoftë, ku mendon kapiteni që mund të kiushim ndonjë pikë më shumë? Presidentit I mungon në kalkulimin e tij një pikë me Italinë...

Unë do të shtoja edhe 3 pikët me Izraelin në Elbasan. Gjithsesi e mira nuk ka fund. Ndashjes me Italinë i shkuam shumë pranë barazimit dhe mendoj që ishte mëse e mundur të merrnim 1 pikë, jo se mund të na shërbente për efekt kualifikimi, por më shumë si një rezultat historik për kombëtaren, pasi kundër Italisë nuk na qëllon shpesh t ë

ndeshemi dhe një barazim do të kujtohej shumë herë më gjatë se një lojë e mirë por pa rezultat.

Ansi duhet të bëjë edhe rolin e liderit në fushë me ekipin. Një mision që gjithsesi gjen harmoninë edhe te shokët e skuadrës?

Pa diskutim që po. Pa ndihmën e shokëve të skuadrës asgjë nuk është e mundur në një skuadër. Jemi një grup lojtarësh që u bëmë vite që luajmë bashkë, megjithëse koha që kalojmë në grumbullim me ekipin nuk

është shumë e madhe, harmonia dhe mirëkuptimi që kemi me njeri-tjetrin është mjaft e madhe. Lideri ynë më i madh është skuadra, forca e grupit dhe fryma pozitive që kemi për shokun shokun. Dhe, duke pasur në skuadër djem që parësore kanë skuadrën dhe jo objektivat personale, detyra ime bëhet akoma më e thjeshtë. Gjithashtu, edhe lojtarët e rinj të sapothirrur e kanë shumë më të lehtë për t'u ambientuar me frymën e grupit.

Me grupin që ka kombëtarja shqiptare, me skuadrën dhe potencën e treguar, mendon se është një kockë e fortë për të gjithë kundërshtarët e tjerë?

Përgjigjen më të mirë e ka treguar fusha në këtë rast. Asnjë skuadër nuk e ka pasur dhe nuk do ta ketë të lehtë kundrejt skuadrës sonë. Nuk jemi kursyer asnjëherë për të dhënë më të mirën, ndaj çfarëdo kundërshtari.

Ndashja me Italinë kishte edhe një specifikë tjetër. Mbylljen e karrierës të Lorik Canës. Një jetë me futbollin dhe me kombëtaren. Natyrisht skuadra do e mbajë mend gjatë, por edhe ju personalisht?

Loriku është një lojtar që ka dhënë jashtëzakonisht shumë për skuadrën kombëtare dhe meriton respekt nga të gjithë. Kemi kaluar shumë vite së bashku në ekipin kombëtar dhe sigurisht që ato vite që kemi kaluar do ti mbajmë mend për të gjithë jetën, sidomos ato momente të bukura që mbahen mend edhe më gjatë.

A do të jetë Shqipëria një pretendente e fortë për Europeanin e 2020-tës? A mund ta përsërisim sërish një sukses historik?

Çdo gjë është e mundur, por këtë duhet ta tregojnë rezultatet që do kemi në fushatën eliminatore të Europeanit 2020. Formula e re e kualifikimit të jep një mundësi mjaft të mirë për të qënë konkurent deri në ndeshjen e fundit dhe një sukses i përsëritur është mjaft i mundshëm për tu arritur. Kryesorja për momentin është konsolidimi i lojës tonë në mënyrë që skuadra të jetë sa më kompetitive kur kualifikueset të fillojnë. Uroj që ai sukses i vitit 2016 të përsëritet dhe që shqiptarët anëmbanë botës të përjetojnë përsëri ato emocione të mrekullueshme. Vetëm futbollin dhe skuadra kombëtare shqiptare të dhurojnë të tilla emocione.

ELIMINATORET E BOTËRORIT "RUSI 2018"

1).	05.09.2016	Shkodër	SHQIPËRI – Maqedoni	2-1
Shënues: A.Sadiku 9', B. Bala 90'				
2).	06.10.2016	Lihtenshtejn	Lihtenshtejn – SHQIPËRI	0-2
Shënues: Jehlie 11' (aut), B.Bala 71'				
3).	09.10.2016	Shkodër	SHQIPËRI – Spanjë	0-2
4).	12.11.2016	Elbasan	SHQIPËRI – Izrael	0-3
5).	24.03.2017	Palermo	Itali – SHQIPËRI	2-0
6).	02.09.2017	Elbasan	SHQIPËRI – Lihtenshtejn	2-0
Shënues: O.Roshi 54', A.Agolli 78'				
7).	11.06.2016	Hafia	Izrael – SHQIPËRI	0-3
Shënues: A.Sadiku 22', 44', L.Memushaj 74'				
8).	05.09.2017	Strumicë	Maqedoni – SHQIPËRI	1-1
Shënues: O.Roshi 53'				
9).	06.10.2017	Alikante	Spanjë – SHQIPËRI	3-0
10).	09.10.2017	Shkodër	SHQIPËRI – Itali	0-1

BILANCI TOTAL

(10 ndeshje, 4 fitore, 1 barazim, 5 humbje, gol. 10:13) Vendi III-të në grupin "G"
Shënim: (Për herë të parë një pozicionim i këtillë në të gjitha përfaqësimet në Eliminatore të kampionateve Botërore)

NDESHJE NË SHQIPËRI:

(5 ndeshje, 2 fitore, 0 barazime, 3 humbje, gol. 4:7)

NDESHJE NË TRANSFERTË:

(5 ndeshje, 2 fitore, 1 barazim, 2 humbje, gol. 6:6)

GOLASHËNUESIT E SHQIPËRISË:

1).	Armando Sadiku	3 gola
2).	Bekim Bala	2 gola
3).	Odise Rroshi	2 gola
4).	Jehlie (Lihtenshtejn)	1 (autogol)
5).	Ansi Agolli	1 gol
6).	Ledion Memushaj	1 gol

Trainerë të Shqipërisë: Xhani DE BIAZI deri më 11.06.2017
Traineri i ri të Shqipërisë: Kristian PANUCCI fillon më 02.09.2017
 dhe vijon punën në pankinën kuqezi

KOMBETARJA NE ELEMINATORET E BOTERORIT
NDESHJET DHE MINUTAZHI

HYSAJ	10	NDESHJE	889	minuta
ROSHI	9	NDESHJE	703	minuta
MAVRAJ	8	NDESHJE	720	minuta
MEMUSHAJ	9	NDESHJE	655	minuta
AGOLLI	8	NDESHJE	658	minuta
BERISHA	8	NDESHJE	658	minuta
KUKELI	7	NDESHJE	455	minuta
SADIKU	6	NDESHJE	396	minuta
LILA	6	NDESHJE	361	minuta
BASHA	6	NDESHJE	360	minuta
HYKA	6	NDESHJE	359	minuta
XHIMSHITI	5	NDESHJE	377	minuta
LLULLAKU	5	NDESHJE	352	minuta
AJETI	4	NDESHJE	360	minuta
XHAKA	4	NDESHJE	337	minuta
ABRASHI	4	NDESHJE	278	minuta
BALAJ	4	NDESHJE	300	minuta
VESELI	4	NDESHJE	278	minuta
GREZDA	4	NDESHJE	245	minuta
ALIJI	3	NDESHJE	224	minuta
CIKALLESHI	3	NDESHJE	131	minuta
STRAKOSHA	2	NDESHJE	180	minuta
KAÇE	2	NDESHJE	180	minuta
MEMOLLA	2	NDESHJE	62	minuta
AHMEDI	2	NDESHJE	5	minuta
GASHI	1	NDESHJE	60	minuta
LENJANI	1	NDESHJE	46	minuta
BALLIU	1	NDESHJE	45	minuta



KREU I FSHF-së DUKA:

"VENDI I TRETË MË KENAQ, PENG DISA PIKË QË NA MUNGOJNË..."

Presidenti i FSHF-së,
tavolinë me mediat për bilancin
e eleminatoreve të Kombëtares



i një risi më vete, por edhe një qasje e drejtpërdrejtë për të ndarë mendime dhe opinione të ndryshme, Presidenti i FSHF-së Armand Duka zhvilloi një tavolinë bashkëbisedimi me mediat për bilancin e ekipit kombëtar në eliminatore të sapombyllura për Botërorin e Rusisë.

Tema të ndryshme të cilat gjetën një gjetim mes kreut të FSHF-së dhe gazetarëve të pranishëm. Numëri 1 i futbollit shqiptar Duka i bëri një analizë të gjerë të këtij rrugëtimi, duke e cilësuar në total si pozitiv, pavarësisht ndryshimit të trajnerit në rrugë e sipër. Për ecurinë e ekipit kombëtar në fazën eliminatorie, Presidenti theksoi:

"Dy ndeshjet e fundit mund të mbylleshin më mirë nga pikëpamja rezultativ, por në total në këtë edicion, përkufizimin duhet ta japin më mirë ata që mbështesin ekipin kombëtar. Do ta konsideroj një edicion pozitiv. Kemi zhvilluar 10 ndeshje, kemi arritur një vend në klasifikim më të mirin e Shqipërisë. Pengjet janë dy ndeshje, ajo me Izraelin në shtëpi dhe sfida e fundit me Italinë ku mund të merrim një pikë. Vlerësimin e japin më mirë ata që na shohin, tifozët dhe specialistët, por e konsideroj një edicion pozitiv, por që ka problemet e veta. Kemi zënë vendin më të mirë në histori, vendin e tretë. Kemi pasur dy kundërshtarë shumë të fortë në grup, Spanja dhe Italia. Shumë e vështirë t'i kalosh ata. Një renditje pozitive. Në lidhje me punën e stafit të ri do të thosha që gabimet nuk kanë qenë të mëdha. Ka qenë një paraqitje e mirë, ndoshta një lojë jo e mirë, por futbollit është cinik. Në total është një punë e kënaqshme. "Fatkeqësi" e trajnerit aktual Panucci dhe e stafit të tij që kishte dy kundërshtarë shumë të fortë edhe pse ndoshta e meritonim një pikë me Italinë.



Çfarë nuk ka shkuar mirë, apo ndonjë peng? Për ne ka shkuar keq vetëm euforia pas Europianit të Francës. Dhe një diçka të tillë e kam përsëritur shpesh. Ndoshta impenjimi nuk ka qenë maksimal, pas Europianit të Francës. Kjo ka ndodhur deri në ndeshjen me Izraelin. Dhe meqë jemi te Izraeli, do të shtoja se sfida me këtë skuadër në fushën tonë këtu dhe ndeshja e fundit me Italinë mund të shkonin ndryshe. Kemi ndryshuar stafin, por jo për rezultate të dobëta. Tashmë kemi një staf të ri për eliminatorët e Europianit 2020. Nuk harroj të falënderoj as De Biazin, kurrsesi në rrugëtimin e bëri deri në Qershor. Në lidhje me zgjedhjet e trajnerit, apo edhe me përfshirjen e lojtarëve të kampionatit tonë në grumbullimet e tij do të mbetesh të respektimi i zgjedhjeve të trajnerit. Por, kemi shpesh raste kur lojtarë të nivelit të lartë sepse konkurrenti tij është akoma më lart, ndaj janë zgjedhje që varen nga moment dhe pozicioni. Jo vetëm Lilaj, por dhe të tjerë mund të afrohen dhe në ndeshjet e nëntorit trajneri do t'i provojë”.

Ndërkaq, një tjetër mundësi dhe shans real, që nga shtatori i ardhshëm do të jetë edhe Liga e Kombeve, një kompeticion që jep një mundësi shtesë për kualifikimin në Europian. Shqipëria aktualisht gjendet në vazon C. President Duka për këtë kompeticion të ri shtoi: “I kam hedhur një sy ndarjes së grupeve të “Nation League” dhe mendoj se objektivi i Shqipërisë është jo Liga C, ku gjendemi, por Liga B. Ne kemi mundësi reale për të marrë pjesë në mënyrë të vazhdueshme në Europian dhe në ndonjë rast në Botëror. Ndeshjet e fundit kanë konfirmuar se Shqipëria është ekip i fortë dhe kompetitiv”, - shtoi kreu i FSHF-së.

Ndërkaq, një tjetër pyetje me shumë interes dhe ku natyrisht Presidenti përçoll opinionin e tij kishte të bënte me çështjen e tifozëve. Dhe për këtë shqetësim të ngritur, natyrisht që erdhi një përgjigje: “Problemi ynë është bojkoti i ndeshjeve në shtëpi nga grupimi më i rëndësishëm i kombëtares “Tifozat Kuq e Zi”. Lexova diku që jemi të mërëzitur sepse u kontrolluam shumë në Shkodër. Këto arsye nuk janë në kompetencë të federatës. Nuk dua të shfaqesoj Policinë sepse ata bëjnë punën e tyre, për rendin dhe sigurinë në stadium. Diku tejkalohen kompetencat. Gjithsesi, ne jemi për ekipin. Ashtu siç janë edhe tifozët. Edhe këta të fundit duhet të tejkalojnë ndonjë problem dhe këtë e kam për “Tifozat Kuq e Zi” që e bojkotojnë jashtë dhe nuk e mbështesin në Shqipëri për mostrajtim të mirë nga policia. Mund të kenë të drejtë, por nuk duhet ta bojkotosh se dëmton qëllimin e të gjithëve ekipin kombëtar. Uroj që bojkoti të përfundojë. Edhe policia dhe ndonjë faktor tjetër të jenë më luajal dhe të ndryshojë punën për të nisur ndryshe edicionin e ardhshëm”, - shtoi kreu i Federatës Shqiptare të Futbollit.

Një tryezë me mediat që gjithsesi kërkuan të mësonin në lidhje me këtë bilanc të ekipit kombëtar, në ecurinë e tij. Një tryezë bashkëbisedimi që do të vazhdojë mes Presidentit dhe medias në fund të çdo kompeticionit, sikundër zyra e PR e realizoi edhe në muajin maj, me mediat në eventin për mbylljen e sezonit.



STATISTIKAT E UEFA-S PER ELEMINTORET E BOTERORIT

SHQIPËRIA	10 ndeshje
Fituar	4
Barazuar	1
Humbur	5

STATISTIKAT E SULMIT NE KETO 10 NDESHJE

Gola te shenuar	10
Gola per ndeshje	1

GJUAJTJET PER GOL

Total:	103
Ne kuadrat:	32
Jashte porte:	48
Topa te pritur:	23

KROSIME TOPI

Te kompletuara:	44% per 10 ndeshje te luajtura
Krosime te tentuara:	187
Krosime te realizuara:	82

Goditje kendi: per 10 ndeshje

PERFORMANCA E SKUADRES

Saktesia ne pasime:	84%
Pasime te nisura:	4047
Pasime te realizuara:	3450
ZOTERIMI I TOPIT NE 10 NDESHJE:	47%

STATISTIKAT E MBROJTJES

Topa te recuperuar:	311
Raste per pesim goli:	27
Raste goli te evituar nga portieri:	41

STATISTIKAT DISIPLINORE

Kartona te Kuq:	2
Kartona te verdhe:	21
Faulla te shkaktuar:	155
Faulla te pesuar:	133




MISTER

PANUCCI:

“ME KURAJO DHE GUXIM DREJT 2020!”

Katër ndeshje dhe një prezantim që premtom. Tash më mister Panucci njeh skuadrën dhe ka një panoramë të plotë për këtë grup. Kërkon shumë, dhe do të guxojë larg, me kurajo dhe guxim. Dhe për këtë ka besim. Shumë të madh madje. Në një bilanc të tij vetë trajneri theksoi: “Kemi bërë shumë rritje gjatë kësaj periudhe. Me skuadrën do synojmë të guxojmë përpara, do dalim nga mbrotja dhe do tentojmë të luajmë në sulm. Do jemi një skuadër më e guximshme dhe keni besim për këtë. Jam shumë i kënaqur me skuadrën që dha gjithçka. Ne nuk do kemi ide për të vënë autobuzin përpara portës. Do luajmë futboll sepse jo gjithmonë do kemi ekipe si Spanja apo Italia si kundërshtarë.

Jam i kënaqur për idenë që po përpiqemi ti japim skuadrës dhe që lojtarët po më ndjekin. Ideja është të mos bëjmë më hapa mbrapa, por hapa përpara. Kemi një vit kohë për të përgatitur Europeanin 2020. Jam i sigurt se kjo skuadër e ka cilësinë që të dalë nga zona e sigurisë dhe provojë të bëjë më tepër përpara. Skuadra di ta luajë futbollin që kërkoj. Absolutisht nuk duhet të heqim dorë nga cilësia për sasinë. Duhet të dalim nga “guacka”, sepse këtu njerëzit kanë dëshirë të jetojnë dhe këtë e shoh edhe te skuadra. Djemtë më thonë që duan të provojnë të luajnë në sulm dhe fakti që luajtëm si të barabartë me Italinë është një sinjal që mund të bëjmë më tepër”, - shtoi trajneri.



MIQESORJA NE ANTALIA

KOMBËTARJA FITON BINDSHËM

Pas shumë vitesh kombëtarja e futbollit fiton në Turqi, në sfidën miqësore të 13 nëntorit në Antalia. Nën drejtimin e Panuccit. Kombëtarja kuqezi ka mposhtur Turqinë, me rezultatin 2-3. Sulmuesi Armando Sadiku shënoi dy herë dhe më pas në gol shkoi edhe Eros Grezda. Kuqezinjtë luajtën për më tepër se 50 minuta me 10 futbollistë, pas daljes me karton të kuq të mesfushorit Ledian Memushaj. Kombëtarja e Panuccit funksionoi më së miri, teksa u mbrojt mjaft mirë dhe kundërsulmoi rrezikshëm, duke gjetur golin 2 herë. Për t'u veçuar edhe kombinimi perfekt i dyshes Roshi-Sadiku, me të parin që ka asistuar 2 herë dhe sulmuesin elbasanas që ka dërguar topin në rrjetë. E vetmja notë negative

në këtë 45-minutësh, është kartoni i kuq i Memushajt, pas ndëshkimit me 2 të verdhë. Në fillimin e pjesës së dytë, Turqia gjen menjëherë golin, me anë të sulmuesit të Romës, Under, por vetëm pak minuta më pas, Shqipëria shënon me anë të Grezdës dhe çon rezultatin 1-3. Vendasit shfrytëzojnë epërsinë numerike dhe hidhen në sulm, ndërsa në minutën e 60', ngushtojnë edhe një herë diferencën

e golave, me anë të mesfushorit Akbaba. Paraqitje mjaft të mirë dhuroi edhe i rikthyeri Sabien Lilaj, që për 85 minuta ishte një pikë referimi në mesfushën e Shqipërisë. Në pjesën e dytë u aktivizuan edhe dy risitë e grumbullimit të Panuccit, Astrit Ajdareviç dhe Kamer Qaka, por për vetë situatën e lojës, në kohën kur u aktivizuan, ishte e pamundur të krijonë një ide më të qartë për cilësinë e tyre.



Më pranë Kombëtares me kartën Kuqezi



UNIONBANK
Banka që dua

Nga bashkëpunimi i FSHF dhe Union Bank tashmë kushdo mund të përfitojë kartën Mastercard të personalizuar me notat e kombëtares shoqëruar me plot surpriza të tjera.

- Biletë e garantuar për ndeshjet zyrtare Euro/Fifa qualifiers
- Skonto 5% - 10% zbritje në dyqanin e FSHF
- Çmim preferencial me 10-25% zbritje në ndeshjet miqësore

Aplikoni online në www.fshf.org apo në www.unionbank.al

UEFA NATIONS LEAGUE

një tjetër shans për EURO 2020

Shtatori i ardhshëm do të gjejë skuadrën kombëtare në një tjetër kompeticion, për një tjetër mundësi, atë të Ligës së Kombeve: Kështu, në vitet në vijim, futbollit i ekipeve përfaqësuese të kontinentit evropian do të luhet non-stop, sepse ka

lindur: UEFA Nations League, projekti më i fundit i UEFA-s dhe që do të nisë rrugën e gjatë në Shtatorin e vitit 2018. Të 55 federatat pjesëmarrëse do të ndahen në 4 divizione A-B-C-D në bazë të klasifikimit të përgjithshëm të UEFA-s dhe si bazë është marrë renditja e klasifikimit të UEFA-s pas datës 11 tetor. Divizionet A dhe B do

të përfshijë 12 skuadra, ndërsa ai C do ketë 15 skuadra dhe divizioni D ku do të jenë 16 skuadra. Divizionet

Si janë ndarë Divizionet?

Divizioni A:

Gjermania, Portugalia, Belgjika, Spanja, Zvicra, Franca, Anglia, Italia, Polonia, Kroacia, Islanda, Hollandë.

Divizioni B:

Rusia, Rep. Irlandës, Sllovakia, Suedia, Uells, Ukraina, Bosnja, Irlanda e Veriut Austria, Turqia, Irlanda, Danimarka dhe Çekia.

Divizioni C:

SHQIPËRIA, Hungaria, Mali i Zi, Serbia, Skocia, Çekia, Rumania, Greqia, Slloveni, Bullgaria, Izraeli, Norvegjia, Qipro, Finlanda, Estonia dhe Lituania.

Divizioni D:

Azerbajxhani, Bjellorusia, Gjeorgjia, Armenia, Maqedonia, I. Faroe, Luksemburgu, Letonia, Moldavia, Kazakistani, Lihtenshtejni, Andorra, Malta, Kosova, San Marino dhe Gjibraltari.



FINAL COMPOSITION OF THE LEAGUES

League A		
1	Germany	40,747
2	Portugal	38,655
3	Belgium	38,123
4	Spain	37,311
5	France	36,617
6	England	36,231
7	Switzerland	34,986
8	Italy	34,426
9	Poland	32,982
10	Iceland	31,155
11	Croatia	31,139
12	Netherlands	29,866

League B		
13	Austria	29,418
14	Wales	29,269
15	Russia	29,258
16	Slovakia	28,555
17	Sweden	28,487
18	Ukraine	28,286
19	Rep. of Ireland	28,249
20	Bosnia-Herzeg.	28,200
21	Northern Ireland	27,127
22	Denmark	27,052
23	Czech Republic	27,028
24	Turkey	26,538

League C		
25	Hungary	26,486
26	Romania	26,057
27	Scotland	25,662
28	Slovenia	25,148
29	Greece	24,931
30	Serbia	24,847
31	Albania	24,430
32	Norway	24,208
33	Montenegro	23,912
34	Israel	22,792
35	Bulgaria	22,091
36	Finland	20,501
37	Cyprus	19,491
38	Estonia	19,441
39	Lithuania	18,101

League C		
40	Azerbaijan	17,761
41	FYR Macedonia	17,071
42	Belarus	16,868
43	Georgia	16,523
44	Armenia	15,846
45	Latvia	15,821
46	Faroe Islands	15,490
47	Luxembourg	14,231
48	Kazakhstan	13,431
49	Moldova	13,130
50	Liechtenstein	10,950
51	Malta	10,870
52	Andorra	10,240
53	Kosovo	9,950
54	San Marino	8,190
55	Gibraltar	7,550

UEFA National Team Coefficient Rankings of 11 Oct 2017

- WC 2014 (Q/FT) 20%
- EURO 2016 (Q/FT) 40%
- WC 2018 (Q) 40%

As per UNL competition regulations, Annex D.1.2

A dhe B do të kenë nga 4 grupe me po kaq skuadra ndërsa divizioni C një grup me tre skuadra dhe tre grupe me katër. Në divizionin D janë formuar 4 grupe me nga 4 skuadra. 4 te parat e çdo grupi do të ngjiten një grup më lart, ndërsa 4 të fundit do të bien një grup më poshtë.

Ky kompeticion do të ndryshojë formatin e kualifikimit në Kampionatin European, duke i dhënë një shans më shumë kualifikimi ekipeve të mesme dhe të dobta që nga Kampionati European 2020 dhe më tej.

FORMATI

Liga e Kombeve do të ndahet në 4 liga (A, B, C, D) dhe secila prej tyre do të ketë 4 grupe (1, 2, 3, 4). Grupet e ligave A dhe B do të mbajnë nga 3 ekipe. Grupi 1 i Ligës C do të mbajë gjithashtu 3 ekipe, ndërsa 3 grupet e tjerë të kësaj lige do të mbajnë nga 4 ekipe. Grupet e Ligës D do të kenë nga 4 ekipe.

SI DO TË LUHET?

Në përfundim të ndeshjeve të grupeve, të cilat do të luhen në 6 ditë ndeshjesh në periudhën shtator-nëntor 2018, fituesit e çdo grupi të ligave B, C dhe D do të ngjiten në ligën përkatëse më lart për sezonin e ri të Ligës së Kombeve. Ndërkohë ekipet e renditura në vendet e fundit të çdo grupi të ligave A, B dhe C do të rrëzohen në ligën përkatëse mëposhtë për sezonin e ri të Ligës së Kombeve.

PARALELISHT EDHE ELEMINTORET E EUROPIANIT

Në mars 2019 do të fillojnë kualifikueset e Kampionatit European, të cilat do të zhvillohen në 10 ditë ndeshjesh (2 për çdo muaj) në mars, qershor, shtator, tetor dhe nëntor. Në përfundim të kualifikueseve, 2 ekipet e renditura të parat në secilin prej 10 grupeve (5 grupe me 6 ekipe dhe 5 grupe me 5 ekipe) do të kualifikohen direkt në Kampionatin European.

Ndërkohë 4 vendet e mbetura për në Kampionatin European do të ndahen nga 1 për secilën prej ligave të Ligës së Kombeve. Kryesueset e çdo grupi të Ligës së Kombeve do të zhvillojnë përballje play-off (2 gjysëmfinale dhe 1 finale) me kryesueset e grupeve të tjera të ligës përkatëse në mars 2020, duke krijuar 4 grupe play-off. Fituesi i secilit prej grupeve të play-off do të kualifikohet për në Kampionatin European. E thënë më thjesht, 16 ekipet më të dobta në Europë sipas renditjes përfundimtare të Ligës së Kombeve do të kenë të sigurt një biletë në Kampionatin European. Në rast se një

NATIONAL TEAM COMPETITIONS 2018-20



ekip fitues grupi në Ligën e Kombeve do ta ketë siguruar kualifikimin për në Kampionatin European përmes kualifikueseve, atëherë vendi për

në play-off të Ligës së Kombeve do t'i kalohet ekipit të pakualifikuar të renditur më mirë pas ndeshjeve të luajtura në Ligën e Kombeve.



TURNEU KUALIFIKUES U-19 NË TIRANË E KAMËZ

NJË PËRVOJË E BUKUR

☀️ UEFA nuk është hera e parë që i delegon FSHF-së organizimin e turneve të tillë në Shqipëri. Tanimë është fituar një eksperiencë pozitive e cila po vjen gjithnjë duke u përsosur

nga **Fatmir EFICA**

Shqipëria sjell një tjetër shembull pozitiv në organizimin e turneut kualifikues të grupit të 12-të për U-19. Në datat 4, 7 e 10 tetor 2017 në dy stadiumet "Selman Stërmasi" të Tiranës dhe Kamzës 20 km në periferi të kryeqytetit, Shqipëria me cilësinë e vendit organizator, së bashku me tre skuadrat e tjera Ukrainë, Norvegji e Mali i Zi, falë masave tekniko – oranzitative, kushteve ideale të motit, atmosferës mjaft pozitive të krijuar në të dyja stadiumet ku u luajtën ndeshjet, akomodimit në ambiente fantastike buzë bregdetit, duhet thënë se jo thjeshtë kaloi suksesshëm një "provë". Por, fitoi një tjetër përvojë e cmuar që po vjen madje duke u konsoliduar gjithnjë e më pozitivisht. Parësore kuptohet ka qenë e mbetet për kategori moshe të futbollistëve deri në U-19 përcjellja qartësisht e mesazhit për afirmimin e futbollistëve të rinj të talentuar. Shqipëria ka tani meritën sepse e ka afishuar pozitivisht dëshirën dhe po bën gjithcka të përafrohet me këto standarte të reja që kërkon futboli dhe të grupmoshat e reja nga U-21, U-19, U-17, U-15, futbollin e femrave, etj.



RENDITJA PER FUNDIMTARE NE GR. 12

1.	UKRAINA	9	(3-0-0 7:1)
2.	NORVEGJIA	6	(2-0-1 11:3)
3.	MALI I ZI	3	(1-0-2 1:7)
4.	SHQIPËRIA	0	(0-0-3 1:9)

DISA FAKTE DHE STATISTIKA NGA TURNEU KUALIFIKUES NË SHQIPËRI PËR U-19

* Në 6 ndeshje dhe u shënuar 20 gola, me mesataren e mirë, madje të lartë 3.33 gola për ndeshje.

* Skuadra që shënoi më tepër ishte Norvegjia (11 gola) dhe pësoi më shumë Shqipëria (9 gola).

* Në të tria ndeshjet e turneut nuk pati asnjë barazim.

* Golashënuesi më i mirë ishte Erlind Halland i Norvegjisë që realizoi në total 4 gola, duke shënuar në dy takimet e para nga një gol dhe në të tretin një dygolësh.

* Në total u dhanë dy 11-metërsha ku një u humb nga ukrainasi Oleksiu Khakolov ndaj Shqipërisë (51') dhe një që u realizua nga malazezi Ilij Vukotic (70') po në ndeshjen me Shqipërinë.

SKEDAT E NDESHJEVE

NDESHJET E DITËS SË PARË DT. 04.10.2017

Në stadiumin "Selman Stërmasi" Tiranë, ora 14:00



UKRAINË – SHQIPËRI



1-0

Shënues: Supriaha 30'

UKRAINA: Kuceruk, Bondar, Mykoinko, Khakhlov, Kornilenko, Buletsa (76' Remeniuk), Supriaha, Bilialiev (46' Musolitin), Sukhar (87' Dryshliuk), Avraenko, Khaschuk). (Në dispozicion: Kozhukhar, Safronov, Veremilenko, Cek, Kulakov, Kozylienka). Tr. Oleksandr Petrakov.

SHQIPËRIA: Qirko, Cela, Abara, Gjujra, Rama, Rada, Burba, Myrteza (Metolli 78'), Berisha (Haxhiu 63'), Kumbulla, Lleshi (Gërsho 74'). (Në dispozicion: Tafa, Gurini, Lakti, Isufi, Busha, Hysaj). Tr. Erjon BOGDANI.

Gjyqtarë: A. Poulsen, V.Skyte (Danimarkë), R.Paglies (Francë).

Kartona të verdhë: Bilialiev 30', Avraenko 41', Dryshlyuk 90'+4 / Lleshi 40', Rama 58'

Vëzhgues i Uefa-s: Peter Johns (Angli)

Delegat i Uefa-s: Marton Esterhaszy (Hungari).

Shqipëria kreu ndaj Ukrainës një paraqitje më shumë se dinjtoze. Por Ukrainasit e rinj që shënuan të parët me Vlodislav Supriahën dhe në 51' shpërdoruan edhe një 11-metërsh me Khakolov, të cilin e priti portieri shqiptar Pano Qirko, ditën të ruajni qetësinë e të administrojnë me kujdes gjithçka. Formacioni shqiptar pavarësisht rezultatit nuk është "dorëzuar".



NORVEGJI – MALI I ZI



3-0

Shënues: Markovic 27', Haland 65', Svendsen 84'

NORVEGJIA: Odegard, Brchegrevink, Salte, Oestigaard, Vetiesen, Markovic (73' Agouda), Hauge (46' Pedersen), Olsen, Berkeiet, Vinjor, Haaland (85' Pedersen). (Në dispozicion: Lund, Hadzic, Ueland, Duman, Mickelson). Trainer: Pal Arne Johansen.

MALI I ZI: Milovic, Krulanovic, Roganovic, Terzic, Jablan, Hot (46' Grubac), P.Krstovic (61' Krjestorac), Zecevic (71' Marusic), N.Krstovic, Vukotic. (Në dispozicion: Dukic, Kumburovic, Ceklic, Pelicic, Bujanja, Becirovic). Tr. Aleksander Miljenovic.

Gjyqtarë: Aliyar Aghayev, Zeynal Zeynalov (Azerbajxhan), Fisnik Thorja (Shqipëri)

Kartona të verdhë: Bechegrevink 59' / Jablan 57' / Krjestorac 78'

Delegat i UEFA-s: Stavros Tritsonis (Greqi).

DITA E DYTË, 07.10.2017

Në stadiumin "Selman Stërmasi" – Tiranë, ora 12:00



MALI I ZI – SHQIPËRI



1-0

Shënues: Vukotic 70'(p)

MALI I ZI: Milovic, Roganovic, Terzic (75' Bujanja), Kumburovic, Hot, N.Krstovic (89' Marusic), Zecevic P.Krstovic (68' Becirovic), Pelicic, Drincic, Vukotic. (Në dispozicion: Krulanovic, Jablan, Dukic, Ceklic, Grubac, Krjestorac). Tr. Aleksander Miljenovic

SHQIPËRIA: Qirko, Gurini, Cela, Gjura (Metolli 72'), Rama, Lakti (Lleshi 59'), Burba, Myrteza, Kumbulla, Gërshos (Rada 76'), Haxhiu. (Në dispozicion: Tafa, Abara, Isufi, Busha, Hysaj, Berisha). Tr. Erjon BOGDANI.

Gjyqtarë: A. Poulsen, V.Skyte (Danimarkë), A.Aghayev (Azerbajxhan).

Kartona të verdhë: / Kumbulla 70', Mrteza 72'

Vëzhgues: Stavros Tritsonis (Greqi)

Delegat: Marton Esterhaszy (Hungari)

U konsiderua "fotokopje" humbja tjetër po 0-1 e Shqipërisë edhe ndaj Malit të Zi. Madje sërish goli ka ardhur nga një 11-metërsh, nga një gabim "naiv" në mbrojtje. Ndryshe nga ndeshja me Ukrainën që portieri Qirko e evitoi 11-metërshin, ndaj malkezëve portieri shqiptar e kuptoi krahu por pa mundur ta ndalë goditjen e Vukotit që ka qenë edhe fatskjellës për U-19 e malit të Zi që kanë fituar nëpërmjet këtyre goli nga pika e bardhë. Natyrisht bashkë me humbjen Shqipëria zbehu krejt mundësitë e shanset për të marrë një kualifikim në grupin e 12-të.



UKRAINË – NORVEGJI



2-1

Shënues: Mykolenko 16', Supriaha 84' / Haland 8'

UKRAINA: Kuseruk, Bondar, Mykalenko, Khakhlov (Dryshliuk), Kornilenko, Buletsa (Remeniuk 89'), Supriaha, Bilialiev, Kozyrenko (Kazhchuk 73'), Sukhar, Avraenko. Tr. O. Petrakov (Në dispozicion: Kozhukhar, Safronov, Veremilenko, Chekh, Kulakov, Musolitin). Tr. Oleksandr Petrakov

NORVEGJIA: Lund, Borchegrevink, Salte, Oestigaard, Vetlesen, Olsen, Berkeiet, Vinjor (86' Bohinen), Svendsen (70' Hauge), Haland, Agouda (60' Msarkovic). Tr. PA, Johansen. (Në dispozicion: Odegard, Hadzic, Pedersen, Ueland, Duman, Mickelson). Tr. Pal Arne Johansen

GJYQTARË: Nikolas Rainville, Benjamen Pages (Francë), Fisnik Thorja (Shqipëri)

KARTONA TË VERDHË: Khakhlov 34', Dryshliuk 75'

/Berkeiet 22', Oestigaard 51', Vetlesen 79'

DITA E TRETË 10.10.2017, ORA 14:00

Në stadiumin "Selman Stërmasi" Tiranë



SHQIPËRI – NORVEGJI



1-7

Shënues: Burba 12' / Haland 18', 28', Markovic 32', 72',

Borchegrevink 44', Oestigaard 66', Pedersen 78'

SHQIPËRIA: Qirko (Tafa 46'), Cela, Abara, Gjura, Rama, Rada (Lakti 57'), Burba, Mrteza, Berisha (Haxhiu 69'), Kumbulla, Lleshi. (Në dispozicion: Gurini, Isufi, Busha, Hysi, Gërshos, Metolli). Tr. Erjon BOGDANI

NORVEGJIA: Odegard, Borchegrevink, Salte, Destigaard, Vetlesen, Markovic, Olsen (Mickelson 46'), Berkeiet, Vinjor, Svendsen (Duman 68'), Haland (Pederson 56'). Tr. Pal Arne Johansen.

Gjyqtarë: N.Raleville, V.Scyte, A.Poulsen (Danimarkë).

Kartona të verdhë: Burba 56', Lakti 65', Myrteza 74', 78', Abara 84', Kumbulla 90'+1.

Kartoni i kuq: Myrteza 87' (2 v).



MALI I ZI – UKRAINË



0-4

Shënues: Buletsa 18', Kaschuk 69', 82', Kornilenko 85'

MALI I ZI: Milovic, Roganovic, Terzic (57' Grubac), Kumburovic, Hot, Zecevic, N.Krstovic, Drincic, Vukotic (83' Pelicic), Bujanja, Becirovic (74' P.Krstovic). (Në dispozicion: Dukic, Krulanovic, Jablan, Marusic, Ceklic, Krjestorac). Trainer: Aleksander Miljenovic.

UKRAINA: Kuscheruk, Bondar, Mykulenko, Khakhlov, Kornilenko, Buletsa (75' Kulakov), Supriaha, Bilialiev (62' Musolitin), Kozyrenko (28' Kashchuk), Sukhar, Avraenko. (Në dispozicion: Kozhukhar, Safronov, Veremilenko, Chekh, Remeniuk). Tr. Oleksandr Petrakov.

TURNETË E UEFA-S, U-17 DHE WOMEN'S U-19

17 VJEÇARËT, PA FAT ME SPANJËN E KROACINË

nga **Erdis ÇEPELE**

Pas kombëtares U-19, radhën e kishin dy turnetë e tjerë, organizimin e të cilave, UEFA ia kish besuar sërish FSHF dhe Shqipërisë. Radhën e kishin në mesin e muajit, djemtë e ekipit U-17 të trajnerit Mustedanagiq. Një skuadër e cila përpos vetëm 3 pikëve që arriti në fund të ndeshjeve, rregjistroi një përballje jashtëzakonisht pozitive me skuadra me peshë në moshat e Europës, Spanjën dhe Kroacinë. Fillimisht Kroacia me një 11-metërs dhe më pas Spanja, ku pas pësimit të golit



me skuadrën përfaqësuese spanjolle guxam dhe ishim fare afër barazimit. Sidoqoftë një përfaqësim që premtonte, edhe pse nuk prodhoi një kualifikim. Kaluan grupin Spanja e Kroacia teksa skuadra e 17-vjeçarëve shqiptarë fitoi vetëm kundër Lihtenshteinit, por duke mos patur pas edhe fatin. Sidoqoftë pritshmëritë janë shumë të mëdha për këtë brez që do vijojë më tej.

TURNËU I FEMRAVE U-19

Tetori i ngarkuar me prezantimet ndërkombëtare të turneve zyrtarë

eliminatore do të mbyllet me eventin e femrave të moshës U-19. Skuadra përfaqësuese shqiptare në këtë garim përballë kishte Spanjën, Ukrainën dhe Azerbajxhanin. Vetëm një pikë për skuadrën e vajzave të trajnerit Dede, pikë të cilën e morën kundër Azerbajxhanit në ndeshjen e fundit, teksa dy takimet e para u mbyllën me humbje. Një grup vajzash që vetëm pak muaj më parë kishin fituar kupën e turneut "Montenegro Cup", dhe që janë tërësisht një mundësi më shumë për skuadrën kombëtare A të trajnerit Grima.

KLASIFIKIMI PËRFUNDIMTAR

EKIPET	L	F	B	H	+/-	P
Kroacia	3	2	1	0	7	7
Spanja	3	2	1	0	4	7
Shqipëria	3	1	0	2	3	3
Lihtenshtejni	3	0	0	3	-14	0

Legjenda: L: Luajtur F: Fitore B: Barazime H: Humbje +/-: Diferencagolave P: Pikët

NDESHJET E LUAJTURA:

19 TETOR 2017 Raundi Kualifikues (Grupi 2)

Spanjë 3 - 0 Lihtenshtejn
Stadiumi "Niko Dovano"

Shqipëri 0 - 1 Kroaci
Stadiumi "Selman Stërmasi"

22 TETOR 2017 Raundi Kualifikues (Grupi 2)

Spanjë 1 - 0 Shqipëri
Stadiumi "Selman Stërmasi"

Kroaci 6 - 0 Lihtenshtejn stadiumi
Stadiumi "Elbasan Arena"

25 TETOR 2017 Raundi Kualifikues (Grupi 2)

Kroaci 1 - 1 Spanjë
Stadiumi "Elbasan Arena"

Lihtenshtejn 0 - 5 Shqipëri
Stadiumi "Selman Stërmasi"

SKEDAT E NDESHJES

SHQIPËRI 0-1 KROACI

Golashenues: Krizmanic '78

Shqipëria: Malaj, Murati, Malo, Smajlaj, Shima, Arapi ('37 Gjini), Bozhanaj, Bullari (c) ('57 Kuqi), Morina, Pici, Mazari ('46 Ibrahim)

Kartone te verdhe: Bullari '51, Smajlaj '63, '77, Pici '82

Kartone te kuq: Smajlaj '77

Trajneri: Dzemail Mustedanagic

Kroacia: Ziger, Ilicic ('64 Svrznjak), Vuskovic, Hrvoj, Cuiç ('64 Kupresak), Brnic ('71 Jenjic), Fruk, Saric, Marin, Putnik, Krizmanic (c)

Kartoneteverdhe: Ilicic '18, Brnic '22, Vuskovic '39, Jenjic '72, Svrznjak '80+3

Trajneri: Petar Krpan

SPANJE 1-0 SHQIPËRI

Golashenues: Touaizi Zoubdi '77

Spanja: Urena, Moragas, Busquets, Ruiz, Bayon ('73 Perez), Touaizi Zoubdi (c), Salvatierra, Martinez, Fernandez, Rodriguez ('80 Dorta), Karabinaite ('64 Teguia)

Kartoneteverdhe: Salvatierra '40+1, '80+3

Kartonetekuq: Salvatierra '80+3

Trajneri: Albert Celades

Shqipëria: Malaj, Murati, Malo, Shima, Bozhanaj, Bullari (c) ('72 Mazari), Ibrahim ('63 Arapi), Morina, Pici, Rama ('80 Haveri), Gjini

Kartoneteverdhe: Ibrahim '13, Morina '88

Trajneri: Dzemail Mustedanagic

LIHTENSHEJN 0-5 SHQIPËRI

Golashenues: Bozhanaj '10; '21; '50; Rama '24; Bullari '33

Lihtenshtejni: Foser, Netzer ('58 Beck), Buchel, Biedermann, Unterrainer (c), Graber, Salanovic, Allaart, Luchinger ('70 Tschupp), Frick ('51 Eggenberger)

Kartoneteverdhe: Netzer '14, Graber '32, Luchinger '37, Beck '80

Trajneri: Michael Koller

Shqipëria: Pegini, Smajlaj, Shima ('41 Beqja), Bozhanaj, Bullari (c), Ibrahim ('49 Ibrahim), Morina, Pici, Rama ('54 Hida), Mazari, Haveri

Trajneri: Dzemail Mustedanagic



UEFA

GRASSROOTS
PROGRAMME



REPUBILIA E SHQIPËRISE
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT



FEDERATA
SHQIPTAR E
FUTBOLLIT

PROJEKTI "GROW"
FUTBOLLI
NË SHKOLLA





GROW

FUTBOLLI DUHET TE RRRITET

☀ Pas Grassroots, edhe Grow, një tjetër angazhim në start për futbollin e fëmijëve, prioritet absolut i FSHF-së

nga **Gazmend MALO**

Futboli është padyshim sporti më popullor sot në Shqipëri dhe madje me diferencë të madhe nga sportet e tjera. Kjo mund të argumentohet me disa shifra nga një studim i kryer vitin që kaloi nga një agjenci ndër më të mëdhatë Europiane në grumbullimin dhe përpilimin e të dhënave. E sipas këtyre indicieve rezultojn se mbi 65% e shqiptarëve janë të interesuar dhe ndjekin futbollin, me një përqindje jo të vogël të publikut femëror: Mbi 14% e totalit janë femra. Nëse shikojmë të shikojmë statistikën e atyre që luajnë futboll, përqindja bie në mënyrë të ndjeshme: 27% e fëmijëve dhe 18% e të rriturve praktikojnë futboll, për një total prej 45%. Por, cila është situata që në zanafillë. Më konkretisht:

Sot në Shqipëri luajnë futboll rreth 8.000 fëmijë dhe adoleshentë. Disa luajnë për pasion, disa luajnë për argëtim, disa luajnë ndoshta për profesion, por

e rëndësishme është që ata luajnë futboll. Në moshën e tyre kjo është gjëja më e rëndësishme. Futbollin është një sport i cili pasuron jetën dhe edukimin e fëmijëve (djem dhe vajza) me disa cilësi shembullore:

- o Edukim fizik
- o Disiplinë
- o Vlera sociale
- o Arritje rezultatesh kolektive
- o Njohje e lidershit në nivele të ndryshme (trajner, kapiten, punë në grup), etj.

Kështu, Federata Shqiptare e Futbollit, kur propozon rritjen

e futbollit, propozon diçka të mirë dhe me vlera ekselente sociale. Por, futbollin duhet të mbillet, të kultivohet dhe pastaj jep fryte. Rritja dhe zhvillimi i futbollit në Shqipëri është një detyrë shumë e vështirë për shumë arsye, por nëse disa aktorë dhe partnerë bëhen bashkë, me ekspertizën, dëshirën dhe vullnetin për ta zhvilluar futbollin, kemi bindjen se rezultatet nuk do të vonojnë.

KONKRETISHT, PROJEKTI NE FJALË QUHET GROW = RRRITJE

Ky projekt do të ketë ka në fokus rritjen dhe zhvillimin futbollit të luajtur që në moshë të vogël dhe kërkon angazhim të gjithanshëm, duke përfshirë burime njerëzore dhe financiare të rëndësishme, drejtime në të cilat ne kemi vendosur të investojmë edhe më shumë se në të kaluarën. Federata Shqiptare e Futbollit ka qënë gjithmonë në linjë të parë përse i përket investimeve, duke mbuluar shpesh edhe investimet teknike, apo infrastrukturore të cilat në vende të tjera nuk janë detyrë e federatave.

IMPLEMENTIMI I PROJEKTIT

Më konkretisht, projekti GROW, do të konkretizohet nëpërmjet një projekti pilot me shkollat fillore dhe parashikon tre drejtime:

1. Drejtimi i parë, nëpërmjet suportit të Ministrisë së Arsimit, parashikon hartimin e planit të numërit të shkollave ku do të zbatohet projekti.

a. U7: 17 skuadra dhe 204 fëmijë në vitin e parë



b. U9: 50 skuadra dhe 600 fëmijë ne vitin e parë
 c. Objektiv është trefishimi i këtyre shifrave brenda afatit pesëvjeçar.

2. FSHF do të trajnojë dhe do të liçensojë falas figurat e trajnerit të cilat do të formohen dhe do të liçensohen në profesionin e trajnerit të futbollit për moshat përkatëse.

3. Drejtimi i tretë parashikon një bashkepunim të ngushtë midis Shkollave dhe klubeve lokale për të mundësuar selektimin e fëmijëve më të talentuar për t'i kaluar në një nivel më profesional trajnimi dhe angazhimi.

NJË TRYEZË PËR FUTBOLLIN E FËMIJËVE

"GJITHÇKA PËR FËMIJËT" ishte eventi i radhës që FSHF organizoi në ditët e fundit të nëntorit në "Hotel Tirana" me prezencë të Presidentit të FSHF-së Armand Duka, Sekretarit të Përgjithshëm Ilir Shulku, ish-kapitenit kuqezri Lorik Cana, dhe një paneli të zgjeruar prindërisht,

akademikësh dhe trajnerësh. Futboli i fëmijëve është prioritet absolut i FSHF-së, kjo tryezë ndau opinionet e përfaqësuesëve të federatës, trajnerëve, prindërve, fëmijët e të cilëve impenjohen në ekipe të ndryshme. Presidenti Armand Duka në fjalën e tij theksoi :- "Në fillim të sezonit prezantuam projektin "Topi Yt". Jemi e vetmja federatë që e kemi ndërmarrë një gjë të tillë. Një projekt tjetër pilot është "Grassroots". Sot, futboll luajnë 8 mijë fëmijë, disa për pasion, të tjerë me qëllim që ta kthejnë në profesion. Federata është gjithmonë në mbështetje të kësaj grupmoshe, por jo vetem. Nëse nuk bëhen futbollistë do të bëhen njerëz më të mirë. Ne marrim një lloj "feedback"-u nga prindërit, çfarë duhet të përmirësojmë dhe ku është më e nevojshme". Në një kohë që për pjesën e manualit të licensimit referoi Aldi Topciu dhe Kejdi Tomori për projektin "Groë". Evente të tilla do të vazhdojnë dhe në të ardhmen në qytete të ndryshme me fokus te fëmijët.





LORIK CANA

KAPITENI SIMBOLI KOMBËTARES KUQEZI



Lorik Cana zgjodhi Italinë dhe i dha "lamtumirën" emocioneve kuqezi përjetuar në 13 vite dhe një rekord ndeshjesh 93 duke qenë një rekordmen absolut deri më tani në këtë tregues. Edhe mbrëmja e 22 tetorit 2017 ka patur një tjetër surprizë. Në stadiumin "Velodrom" të Marsejës sërisht është bërë një shkëlqim "lamtumirë" topi. Atje në Francën ku kariera profesionale e Lorik Canës do të merte përmasat e saj shpërthyes.

Lorik Cana vendosi t'i varë "këpucët në gozhdë" pas një karriere brilante. Shumë të vecantë madje që ka bërë një futbollist klasi e me noblesë njerëzore, qytetare e sportive për ta shndërruar në një personalitet spikatës. LORIK CANA, kapiteni që u bë dhe do të mbetet përjetësisht simbol për atë evidentim mjeshtëror të karrierës së tij. Që, një ditë dihet, do "stopohet". Cana që në fushë ka qenë gjithnjë "strateg" vendosi të mbajë tashmë në "arkiv" shumë futbolldashës të të gjitha trojeve shqiptare, këtej dhe andej kufirit, madje të shpërndarë dhe nëpër kontinente.

KARIERA ME KOMBËTAREN

Ishte djalos kur debutoi me 2003 pikërisht në një ndeshje kundër Zvicrës. Zevendësoi Geri Cipin. Nuk i përfillit kritikata e klubeve ku kishte luajtur për të zgjedhur një Përfaqësuese si Zvicra, apo edhe Franca. Veç tij vetë Canës, ishte presidenti i FSHF-së Armand Duka dhe ish-traineri gjerman i Kombëtares Hans Peter Brigel njerëzit që i dhanë mundësinë të niste e zhvillonte parreshtur "epokën" e skicuar në 13 vite me një profil fantastik: 93 ndeshje, 1 gol i shënuar janë "skalitur" tanimë në "muzeun" e një historie që e ka parformancën e Lorikut si një "etalon".

RESPEKTI DHE TANI... NOSTALGJIA PËR TIFOZËT

Do ti mungojnë shumë. Ndërtimi i raporteve me tifozët kuqezi nga Lorik Cana kishte një "kod" special. Të tillë për ta quajtur të jashtëzakonshëm. Pasi në stadium sa herë luante Loriku ishin të grumbulluar tifozët shqiptarë nga të gjitha trojet brenda e jashtë Shqipërisë. Nr.5 ka qenë kapiteni i njëmijë e një betejave prandaj dhe tifozeria shqiptare dhe jo vetëm ka ndarë me kapitenin emocione të paparshkuara.

SKEDA:

LORIK CANA

- Datëlindja:	27.07.1983
- Vendlindja:	Gjakovë - Kosovë
- Shtatlartësia:	186 cm
- Pozicioni:	Mbrojtës

KARIERA SPORTIVE:

Me të Rinjtë:

1997-2000	Dardania Lozanë Zvicërr
2000-2001	PSG – Francë

KARIERA SI PROFESIONIST:


Sezone	Skuadra	Shteti
2000-2003	PSG (B)	Francë
2003-2005	PSG	Francë
2005-2009	OI.Marsejë	Francë
2009-2011	Sanderlend	Angli
2010-2011	Gallatasaraj	Turqi
2011-2015	Lacio	Itali
2015-2016	Nantë	Francë
TOTALI:	388 ndeshje,	15 gola

ME KOMBËTAREN E SHQIPËRISË

Nga viti 2003 deri në 2016

Totali 93 ndeshje, 1 gol i shënuar

Join Us, Love Vas





"ARENA KOMBETARE"

**NË KANTIERIN E NJË
VEPRE MADHORE**



IVECO BUS



"PERFAQËSUES ZYRTAR I IVECO BUS NË SHQIPËRI" • 29

info@albatrans.com.al

nga **Lysien NURISHMI**

Shef i Sektorit të Garave në FSHF

Shtatë javët e para të kampionatit kanë konfirmuar edhe një herë momentin e mirë të futbollit tonë.

Kampionati aktual meriton të vlerësohet edhe për një element shumë të veçantë, fitoret e skuadrave udhëtuese. Sipas statistikave-fakt të deritanishme, në 36 ndeshje të luajtura skuadrat vendase numerojnë 24 fitore, 18 takime janë mbyllur në barazim dhe 22 ndeshjet janë fituar nga miqtë.

Një fakt tjetër i rëndësishëm është minimizimi i rasteve të dhunës që ndonjëherë përshkallëzohen pa prituri e pa kujtuar në fakt dhe efektet që sjellin në lidhje me imazhin në tërësi të futbollit tonë, por dhe të skuadrave e individëve. Ndërkaq, duhet pranuar se ka rënie "miti" i fushës vendase si rrjedhojë e kushteve optimale tek të gjitha stadiumet, por edhe eliminimit të presionit nga faktorët e jashtëm. Përshtatja me një realitet më të pranueshëm futbollistik për të respektuar verdiktin e rezultatit të 90 minutave, tanimë konsiderohet pjesë e atij profesionalizmi të aktorëve e protagonistëve të fushës (lojtarëve e drejtuesve).

Gjithashtu, edhe sa i takon golave të shënuar ka një përmirësim, teksa në 64 ndeshje janë shënuar 136 gola me një mesatare pak më shumë se dy gola për ndeshje. Me përjashtim të Partizanit që startoi me një brishtësi të pazakontë kampionatin duke e patur në 4 javët e para "zero" kolonën e golave të shënuar, janë edhe ekipe të tjera si Luftëtari, Lushnja, Vllaznia që kanë një mesatare të ulët shënimi. Surpriza e ketij edicioni është Kamza që me rezultatet e arritura është në 4 vendet e para të renditjes. Kampionati ynë duhet pranuar se ka arritur të marrë një civilizim pozitiv në këto aspekte, falë edhe përkujdesjes nga FSHF-ja ku orientimet e dhëna për minimizimin sa më shumë që të jetë e mundur e akteve të pahijshme nëpër tribunat e stadiumeve shqiptare sjell një ndërgjegjësim gjithnjë e më të mirë.

Nisur nga çfarë kanë dhuruar shtatë javët e para, realisht duhet pranuar se futbollit elitari shqiptar po shfaq shifra interesante garimi. Në vijimësi FSHF-ja ka tërhequr vëmendjen në përmirësimin e kushteve e standarteve që kanë të bëjnë deri në detajet më të imta për të shërbeyer sa më pozitivisht klimës së

FITORET NË TRANSFERTË NË EKUILIBËR

me sukseset brenda fushës!

Gjatë 64 ndeshjeve të luajtura në periudhën shtator-Nentor të kampionatit, rregjistrohen 24 fitore të skuadrave vendase, 18 barazime dhe 22 fitore të skuadrave udhëtuese



rivalitetit e luftës sportive. Janë dhënë sinjale të deritanishme se kampionati i 79-të Kombëtar po materializon bukur mesazhin e zhvillimit e përparimit të futbollit brenda tërë kornizës që

kërkon kjo lojë magjike. Gara do të ketë pritshmëritë e saj, por shifrat e deritanishme kanë rëzuar çdo "bastion" apo edhe faktorët fushë. Flasin shifrat, që ky kampionat rregjistron çdo javë.

Përgjegjësia sociale dhe futbollit

nga **Gazmend MALO**

Shef i sektorit Marketing

Përkufizimi "Përgjegjësi sociale" nuk është gjëja më e thjeshtë në shqip. Jo sepse fjalët janë të vështira apo sepse gjuha jonë është e varfër, por ka një vështirësi tjetër, që ka arsytet e saj të ekzistojë në një kontekst shqiptar me një sistem ekonomie tregu ende të re e të pakonsoliduar.

Në mënyrë analoge, "Corporate Social Responsibility" ose akronimi CSR është një term më se i konsoliduar në botën perëndimore, ku çdo biznes, çdo kompani dhe çdo organizatë vepron me një ndjeshmëri të lartë ndaj ambientit, ndaj komunitetit apo ndaj temave të ndryshme të përzgjedhura sipas axhendës së mundshme në një kohë dhe vend të caktuar.

Paradoksi që ndodh në Shqipërinë tonë të vogël dhe të varfër, është që axhenda e përmendur më lart është shumë e pasur me tema dhe çdo biznes ka vetëm vështirësi në zgjedhje nga sasia dhe larmia e madhe e "hallevë" apo problematikave ku mund të kontribuojnë sadopak.

Një nga temat e mundshme në këtë panoramë, është patjetër edhe futbollit ynë i dashur. Natyrisht mendimi i parë mund të jetë që ky pohim buron nga egoizmi ynë mqs Futbollit, me F të madhe, është puna dhe pasioni ynë.

Kjo është padiskutim e vërtetë, por nuk është ky shkak përse bizneset organizatat apo çdo actor i skenës sociale dhe ekonomike në vend duhet të përqafojë futbollin si temë e angazhimit të tyre social.

Futbollit meriton shumë sepse është një sport i shkëlqyer për nga aftësitë fizike që zhvillon. Jo vetëm meshkujt, por edhe femrat, në vende të ndryshme, mund të zgjedhin programet stërvitore të futbollit në vend të programeve të zakonshme në aktivitetin fizik për të mbajtur trupin në formë (fitness) dhe kjo ka ardhur si pasojë e disa "personal trainer" të cilët identifikuan cilësitë e ushtrimeve përgatitore të futbollit.

Futbollit meriton më shumë sepse siç dihet botërisht ky sport zhvillon cilësi sociale shumë të mira. Duke qenë një sport kolektiv, të mëson disiplinën, organizimin, përkushtimin bashkë me konceptet e objektivave dhe rezultateve. Të mëson se rezultatet arrihen në grup, si pjesë e një skuadre dhe se roli i gjithsecilit është i domosdoshëm brenda një skuadre dhe nuk ka grada apo pozicione pasi janë të gjithë të barabartë.

Futbollit meriton më shumë sepse përcolli përfaqësinë dhe imazhin më dinjtoz që Shqipëria ka arritur në gjithë historinë e saj post diktature e ndoshta edhe shumë më parë. Në Euro 2016 ishim një nga njëzet e katër skuadrat më të mira të Europës dhe e treguam atë me performancën tonë por sidomos me tifozerinë dhe festën e madhe Kuqezi që çuam në Francë.

Mund të shtojmë këtu edhe shumë arsye të tjera, por është më e rëndësishme të tërheqim vëmendjen në një drejtim tjetër. Futbollistët nuk janë specie e rrallë që lindin

20 vjeç dhe janë talente gati për të luajtur futboll. Çdo fëmijë i vogël që luan futboll mund të jetë një talent potencial dhe si i tillë meriton gjithë shanset e mundshme për ta provuar këtë, e nëse nuk del talent, nuk ka gjë, nuk është humbje, sepse ai është zbavitur, është edukuar dhe është formuar mjaftueshëm nga vlerat që përmendëm më lart.

Për t'i mundësuar çdo fëmijë këtë, pa dallim apo diskriminim origjine, vendi, gjinie, ngjyre apo feje, duhet që të kemi sa më shumë fusha sportive ku fëmijët të luajnë. Duhet një transport urban i sigurt që mund të garantojë shërbimin e nevojshëm për të kryer stërvitje një apo dy apo tre here në javë. Duhet pajisje, veshje, topa, etj etj gjera që jo çdokush mund t'ia ofrojë fëmijëve të tyre apo shkollave që drejtojnë.

Këtu pra mund të ndërhyjë çdo biznes, me shumë apo pak lekë, me dëshirën e mirë që bën diçka për komunitetin, për edukimin e pse jo, edhe për zbavitjen e fëmijëve.

Mund të ndiqet shembulli i kompanisë Coca-Cola, e cila njihet si "amerikane" por që në fakt në operimin e saj në këtë drejtim sillet si më e mira e shqiptarëve. Coca-Cola Cup bëhet gati të zhvillohet për here të pestë radhazi dhe bashkon më shumë se 1.500 fëmijë të shkollave nëntëvjeçare, djem dhe vajza, të cilët në fund të garës, marrin edhe një çmim dhe një souvenir nga ky aktivitet.

Mund të pyetet Coca-Cola se përse e bën këtë gjë. Natyrisht që mund të pyetet, por përgjigjia është shumë e thjeshtë. Ndërkohë që ky aktivitet përmendet shkarazi në gazeta apo kronika, me "censurën" se është reklamë, përgjigjia mbetet shumë e thjeshtë: Coca-Cola e bën këtë gjë për filantropi, për kontribut spontan të pakushtëzuar dhe për Përgjegjësi Sociale.

Mund të ndiqet shembulli i fondacionit më të ri, LR5, i themeluar nga Lorik Cana, i cili sërish nuk ka nevojë për asnjë reklamë. Mos e pyesni përse e bën sepse përgjigjia është e qartë si drita: ai do t'i ofrojë të gjithë fëmijëve shansin që ai pati vetë në jetë dhe ai prej futbollit pati një jetë për t'u patur zili.

Duke shpresuar se keto pak rreshta mund të ngjallin sadopak frymëzim apo kureshtje, ju garantojmë dhe ju ftojme të trokisni në derën tonë sepse nuk do të pendoheni. Do të na gjeni duke punuar kokëulur, të gatshëm për çdo bashkëpunim dhe çdo kontribut ndaj futbollit, edhe pse nuk kemi në plan të parë të demonstrojmë punën e madhe që bëjmë çdo vit me dhjetëra fëmijë, me organizimin e dhjetëra kompeticioneve, me farkëtimin e shumë talenteve.

Përgjegjësia sociale, edhe pse nuk gjen mbështetjen e duhur në politikat fiskale, nuk duhet për këtë të braktiset. Ajo nuk duhet të jetë një parullë për t'u përdorur apo një mekanizëm për t'u dukur bukur. Përgjegjësia sociale duhet të jetë pjesë e axhendës së përditshme të punës, të zhvillimit dhe të suksesit të çdo biznesi. Kështu, çdo arritje do të jetë pjesë e asaj skuadre të madhe që është shoqëria ku ne bëjmë pjesë, merita të përbashkëta e me fitore të përbashkëta.



SHËRBIM, EKSPERIENCË, SHËNDET

Spitali Amerikan, Përqafoje jetën!

Gjithmonë më e mira



www.birrapeja.com


BIRRA
PEJA

Ditët e Akademisë së Arbitrimit

MBYLLET FAZA E PARË E SHKOLLËS!

nga **Sokol JARECI**

Ish-arbitër ndërkombëtar i FIFA-s

A Ashtu siç ishte parashikuar në projekt, Akademia e Arbitrimit mori udhë në qytetin e Korçës në ditët e para shtatorit, ku dhe numri i aplikantëve ishte i konsiderueshëm. Falë kontributit të dekanit të Universitetit "Fanoli", njeriut i çili është gjithmonë në ndihmë të futbollit, prof. Gjergji Mero, u bë i mundur zhvillimi i leksioneve në bibliotekën e këtij universiteti. Pritshmëritë në këtë qytet nga numri i aplikimeve ishin shumë të mëdha, por prezenca në ditën e parë dhe në ditët në vazhdim nuk ishin shumë entuziaste, por kjo nuk e zbehu aspak dëshirën e atyre djemve dhe vajzave të pranishëm për të marrë informacionet në lidhje me Rregullat e Lojës, dhe jo vetëm.

Me përfundimin e kursit në qytetin e Korçës në Tiranë ishte seminari i radhës, ku për vetë numrin e madh të aplikimeve seminarin e ndanë në tre grupe. Ajo që bënte në sy në grupet e Tiranës ishte pjesëmarrja e djemve në moshë mjaft të re, vetëm 15 vjeç. Edvini nga Gjirokastra, Saedi nga Kavaja, Gerardi nga Lezha, të cilët edhe pse ishin në proces mësimor ishin mjaft të interesuar për fillimin e kursit, por gjithashtu dhe të impenjuar në frekuentimin e tij. Fakt tjetër në lidhje me grupet e Tiranës ishte dhe pjesëmarrja e vajzave, por dhe e djemve të cilët, edhe pse nuk ishin pjesë e aplikimeve në datat përkatëse kërkonin të bëheshin pjesë e Akademisë gjë e cila menjëherë iu bë realitet.

Për të qenë sa më afër me arbitrimin dhe me figurën e arbitrit



ishite menduar që një pjesë e leksioneve nga Rregullorja e Lojës të jepeshin nga arbitra dhe asistentë aktive, pra që çdo fundjavë janë pjesë aktive e ndeshjeve në Kategorinë Superiore, kjo për vetë faktin për të sjellë eksperiencat personale, por gjithashtu për të sjellë shembuj të freskët nga ndeshjet e luajtura gjithmonë në lidhje me temat që ofronte programi i ditëve të Akademisë. Arbitrat Enea Jorgji, së bashku me Sokol Jarcin ishin dy nga lektorët të cilët u përfshinë në pjesën e rregullores ku pjesën qëndrore e zë arbitri ku Rregulli 12, "Faultat dhe shkeljet" është ajo e cila përbën pjesën kryesore të të gjithë Rregullores së Lojës.

Arjan Mali, Ermal Barushi, Emigers Ganxhi dhe Enea Pashaj u përfshinë në leksionet e pjesës tjetër të rregullores, të cilët duke qenë se janë në pozicionin e asistentit dhe ish-it ata shpjeguan me detaje pjesë nga Rregulla 11 "Pozicioni jashtë loje", e cila vazhdon të jetë një nga rregullat më të komentuar sot në lojën e futbollit.

Por, arbitrat e rinj gjatë kohës në seminarin e Akademisë kanë marrë leksione të përgatitjes fizike duke zhvilluar seanca praktike edhe në fushë si p.sh: mënyra e të vrapuarit

,etj. të cilat me mjaft profesionalizëm erdhën tek këta të rinj nga përgatitësi fizik i arbitrave z.Elton Kodra. Mënyra e të ushqyerit, parandalimi i dëmtimeve, funksionet e organeve kryesore të trupit, etj, ishin pjesë e leksioneve nga mjeku sportiv Dr.Perli Rusi. Se si një arbitër duhet të përgatitet psikologjikisht për ndeshje, si ai duhet të menaxhojë sjelljen e lojtarëve në fushë, si duhet të komunikojë me ta, ishte e gjitha ç'ka profesori i Universitetit të Sporteve të Tiranës Prof.Ylli Zhurda kishte pjesë të leksioneve të tij në orët e Akademisë. Shembujt konkretë të sjelljes së arbitrave me reagimet e lojtarëve, nga kampionati shqiptar dhe ato të huaja i bënë më të kuptueshme leksionet në lëndën e psikologjisë dhe atë të komunikimit.

"Laws of the game" është kushtetuta e lojës së futbollit, pra Rregullat e Lojës, por tashmë arbitrat e rinj duhen të njohin terminologjinë e kësaj rregulloreje edhe në gjuhën angleze, gjë e cila do ti lehtësojë atyre në një të ardhme jo shumë të largët përballjen në komunikimin nëpër ndeshje ndërkombëtare me kolegë dhe instruktorë nga vende të ndryshme. Ansi Çobani ishte mjaft i qartë në shpjegimin e tij, duke e bërë menjëherë të asimilueshëm atë pjesë të fjalorit teknik që erdhi tek këta arbitra në orët e gjuhës angleze.

Faza e parë e kursit u mbyll, këta djem dhe vajza të reja, tashmë me një gjysëm statusi "arbitra të rinj" do të performojnë në ndeshjet e futbollit amator, ku ata do të testojnë dijet e tyre, por gjithashtu do ti shtojnë ato nëpërmjet pjesës së praktikës....

Faza e dytë do të do fillojë në fund të muajit Janar.





Për t'u ndjerë çdo ditë në formë

Uji i Skadrës
Kombëtare
Shqiptare
të Futbollit



Nr. 1 në Cëlësi





► Fusha e Kamzës

Kamza dhe Lushnja, investimet e reja te fushat

Fushat e stadiumeve të Kamzës dhe të Lushnjës kanë qenë edhe investimet e radhë të FSHF-së, në aspektin e infrastrukturës. Të nisura kohë më parë ato në periudhën shtator-tetor kanë përfunduar edhe rikonstruksionet e tyre, duke qenë tashmë të gatshme për vijimësinë e sezonit. Para ndeshjes Lushnja-Kukësi, kryetari i Bashkisë, Fatos Tushe, i shoqëruar nga zëvendëspresidenti i FSHF-së, Lutfi Nuri dhe presidenti i Kukësit Safet Gjici kanë inauguruar stadiumin e rikonstruktuar. Federata ka kontribuar me investimin e saj në këtë impiant, duke ndërruar tapetin e fushës së stadiumit, ndërsa Bashkia ka rikonstruktuar ambientet e brendshme dhe rrethimin.



► "Roza Haxhiu" në Lushnje



Java "GRASSROOTS" në Shqipëri

Tirana ishte stacioni i radhës për aktivitetin e futbollit për fëmijët e moshës nga 8 deri në 10 vjeç, në kuadër të javës së aktivitetit "Grassroots". Nën kurimin e zyrës përkatëse në FSHF në ambientet e kollonave prane sheshit "Nënë Tereza" në kryeqytet, për më shumë se dy orë, fëmijët u aktivizuan në ndeshje të vogla futbollit, me tre pjesë me nga 10 minuta në fushat e improvizuara te kollonat pranë Korpusit Universitar. Jo pak fëmijë të moshës 8, 9, apo edhe 10-vjeç ishin prezentë në këtë aktivitet që ka patur një pjesëmarrje të gjërë në të gjitha zonat rajonale në Shqipëri. Argëtimi ishte pjesë e këtyre takimeve, në këtë projekt që do të vijojë sërish.

"Arena Kombëtare", vlerësohet kandidatura e FSHF

Komiteti Ekzekutiv i UEFA-s, shpalli fitues stadiumin "Vodafone Arena" të klubit të Beshiktashit, për finalen e Superkupës Europiane të edicionit 2018-2019. Në këtë mënyrë kandidatura e Shqipërisë me projektin në zbatim e sipër të "Arenës Kombëtare", së bashku me 5 impiantet e tjera nuk fituan. Pas marrjes së vendimit, presidenti i FSHF-së, Armand Duka deklaroi: "Hymë në këtë garë me një projekt

shumë ambicioz, dhe jo me një impiant të përfunduar dhe në funksion e sipër, si federatat e tjera candidate. FSHF plotësoi me rigorozitet të gjithë dosjen e kërkuar, në të gjitha etapat dhe pikat e kërkuara. Shumë shpejt përfundojmë stadiumin tonë "Arena Kombëtare" me parametra të shkëlqyer dhe do të kthehemi sërish në garë për të sjellë në Tiranë dhe në Shqipëri, vitrinën e futbollit europian", - theksoi Presidenti i FSHF-së.



Liçensimet, mbaron kursi UEFA B vijon UEFA-Pro

Vazhdojnë rregullisht dhe me shumë masivizim edhe kurset e përgatitjes së teknikëve pranë shkollës së trajnerëve në Shqipëri. Sektori përkatës në FSHF, pasi mbylli në fund të muajit tetor kursin UEFA B, vazhdon sipas grafikut kursin e radhës, atë të UEFA-Pro. Periudha e parë për kursin UEFA-Pro zgjati 10 ditë mësimore-teorike. Ky kurs do të ketë një shtrirje gjithëvjetore me 12 runde 10-ditore. Ndërkaq, sipas plan-grafikut të përcaktuar,

puna vijon me pjesën tjetër të kursit UEFA B, ku vlen të theksohet që këtë në këtë vit e ndjekin edhe katër trajnere femra. Pjesëmarrja për marrjen e licensave përkatëse është e një interesi shumë të madh në një kohë që FSHF kuron të gjithë mbarëvajtjen e programit nëpërmjet Macit e Tafajit. Vlen të theksohet që këtë vit ka përfunduar edhe një kurs për trajnerë të portierëve, si dhe do të nisë edhe një kurs për Drejtorët Sportivë.





KEEP IT COOL

COLD COFFEE DRINK WITH MILK



Kompania më e madhe e sigurimeve!

SIGURIMET
E MAKINËS

SIGURIMET
E BIZNESIT

SIGURIMET
E PRONËS

SIGURIMET
E SHËNDETIT

SIGURIMET
E JETËS



SHQIPËRI

SIGAL Business Center
Blv.: "Zogu I", nr. 1, Tiranë, Shqipëri
Tel: (+355) 4 2233 308
Fax: (+355) 4 2250 220
E-mail: info@sigal.com.al
www.sigal.com.al

KOSOVË

Rr. "Vaso Pasha", p.n. Pejton,
10 000, Prishtinë, Kosovë
Tel: (+381) 38 240 241
Fax: (+381) 38 240 241 123
E-mail: info@sigal-ks.com
www.sigal-ks.com

MAQEDONI

Rr. "Marks & Engels" 3,
1000 Shkup, Maqedoni
Tel: (+389) 2 3125 920
Fax: (+389) 2 3215128
E-mail: info@uniqa.mk
www.uniqa.mk

FSHF: PAKETË LIGJORE MULTI DIMENSIONALE!

nga **Aldi TOPÇIU**

Shëf i Sektorit Juridik në FSHF

Ligji i ri "Për Sportin" ka hyrë tashmë në fuqi dhe ndonëse është ende herët për të nxjerrë konkluzione përfundimtare, nuk mund të thuhet se ka sjellë një efekt konkret mbi sportin. Federata Shqiptare e Futbollit e mbështeti në parim këtë ligj si një hap pozitiv ndonëse modest, në përmirësimin e sportit në vend.

Federata Shqiptare e Futbollit ka hasur ndër vite disa problematika, që vlerësohet se pengojnë nxitjen dhe zhvillimin e sportit e që nuk gjetën zgjidhje as me ligjin e ri. Duke marrë shkas nga problemet e përditshme të aktivitetit, janë lehtësisht të identifikueshme dispozitat penguese që kërkojnë ndërhyrje për të kapërcyer vështirësitë e mbartura ndër vite.

Ndryshimet e propozuara nga FSHF synojnë lehtësimin e kuadrit të bashkëpunimit dhe partneritetit ndërmjet organizatave sportive shqiptare me organizatave sportive ndërkombëtare si dhe nxitjes së sportit me qëllim rritjen stimulimit të tij nëpërmjet politikave fiskale e jo vetëm.

DETYRIMET DOGANORE

Dispozitat aktuale që parashikojnë detyrimet doganore kanë qenë një pengesë serioze për përfitimin e sponsorizimeve nga bashkëpunëtorët e donator të huaj të cilët nuk përfshihen në kategorinë e subjekteve të përcaktuara nga legjislati në fuqi. E njëjta problematikë është hasur dhe për furnizimet dhe investimet në fushën e sportit.

Mund të thuhet që disa nga këto kërkesa kanë gjetur pasqyrim në projekt-ligj, siç është propozimi për përjashtimin nga detyrimet doganore dhe tatimin mbi vlerën e shtuar të ndihmave, apo sponsorizimet me materiale dhe pajisje sportive për federatat shqiptare, të cilat vijnë nga institucione sportive ndërkombëtare

apo çdo formë tjetër sponsorizimi në kuadër të bashkëpunimit, nxitjes së sportit dhe rritjes së nivelit të sportit në rang ndërkombëtar.

Por, në të njëjtën kohë, Federata Shqiptare e Futbollit është e mendimit se duke ndërhyrë njëkohësisht në ligjin "Për sportin", ligjin "Për tatimin mbi të ardhurat", ligjin "Për sponsorizimet" atë mbi "Tatimin mbi vlerën e shtuar" si edhe në VKM-të në zbatim të tyre. Dhe kjo do të çojë në përmirësimin e gjendjes ekonomike të klubeve dhe lojtarëve profesionistë, gjendje që do të sjellë më pas edhe rritjen e cilësisë sportive.

FSHF, gjatë gjithë aktivitetit të saj, ka hasur vështirësi serioze me burokraci që lidhen me doganat, TVSH-në dhe vetë bazën materiale aq të domosdoshme për zhvillimin normal të këtij sporti.

Nëse sipas propozimeve të FSHF, një kategori sportistësh siç mund të jenë futbollistët elitarë, ata të ekipit kombëtar, do të përjashtoheshin nga tatimi mbi të ardhurat, sigurisht që do të përbënte një nxitje për t'i afruar talentet edhe nga diaspora drejt sportit.

Po ashtu, nëse furnizimi i shërbimeve të lidhura ngushtë me ushtrimin e sportit ose të edukimit fizik do të përjashtoheshin nga TVSH-ja, këto shërbime do të ishin më të mëdha e më me ndikim në sportin shqiptar.

INVESTIMET

Në këtë drejtim, është propozuar që investimet e lidhura ngushtë me zhvillimin e sportit në Republikën e Shqipërisë të përjashtohen nga TVSH si një mënyrë për të afruar investitorë të huaj e vendas. Një mjet në këtë drejtim mund të jetë ndryshimi i Ligjit për Sponsorizimet, ligj ky i harruar nga i cili, sponsorizuesi nuk përfiton asgjë të qënësishme, gjë e cila pasqyrohet në mungesën e sponsorëve me peshë në aktivitetet sportive.

SPONSORIZIMET DHE REKLAMAT

Më tej, lidhur me reklamat dhe sponsorizimet FSHF ka shprehur prej kohësh rezerva të medha pasi ligji nuk solli asnjë risi dhe se sponsorizimi i një federate, klubi apo sportisti vijon të mbetet një aktivitet pa interes komercial

për investitorët. Kjo çështje mund të adresohet vetëm përmes amendimit të Ligjit për Sponsorizimet ku minimumi që mund të bëhet është të rritet përqindja e njohur si e zbritshme, pasi 5% e fitimit përpara tatimit është realisht jo atraktive për subjektet që investojnë.

ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Tjetër pikë e nxehtë mbetet "Zgjidhja e mosmarrëveshjeve", ku sipas ligjit përcaktohet se mosmarrëveshjet për çështje të lidhura me sportin midis organizatave sportive (në rastin konkret, federatave) zgjidhen në Këshillin e Arbitrazhit Sportiv që do të funksionojë brenda KOKSH, gjë e cila çel domosdoshmërisht diskutimin mbi formalizimin ligjor të këtij Komiteti.

FONDI KOMBËTAR I SPORTIT

Për sa i përket Fondit Kombëtar të Zhvillimit të Sportit nga të ardhurat që sigurohen nga lotaritë sportive, është rasti të kujtojmë se sipas ligjit për lojërën e fatit, krahas detyrimit tatimor, organizatorët duhet të derdhin në llogari të ministrisë përgjegjëse për sportin shumën prej 0,4 % të xhiros vjetore. Në thelb kjo dispozitë nuk ndryshon dhe në këndvështrimin tonë mbetet pa përgjigje si do të menaxhohen këto të ardhura të cilat FSHF nuk i ka përfituar ndonjë herë ndonëse futbollit përbën zërin më të rëndësishëm në kategorinë e basteve sportive.

Problemet e përsëritura të sportit shqiptar kërkojnë zgjidhje që shkojnë përtej ligjit për sportin i cili për hir të së vërtetës ka 10 vjet që amendohet me ndërhyrje kozmetike pa asnjë fryt real për sportin, kjo është arsyeja pse pa një paketw ligjore shumë dimensionale dhe pa vullnetin për ta ndihmuar vërtet sportin, vështirësitë do të mbeten të njëjta.





SEMINARI I LIÇENSIMIT

TOPÇIU DHE GJINI NË BUDVA PËR FAIR-PLAYIN FINANCIAR TË KLUBEVE

Nga data 11-13 Tetor 2017 ne Budva të Malit të Zi zhvillojë punimet Seminari i UEFA-s me temë "Liçensimi i Klubeve & Fair-Play Financiar", workshopi vjetor i vitit 2017. Prezentë në këtë event të 55 Shoqatat anëtare të UEFA-s si dhe të ftuar (Drejtues të Departamenteve të Menaxhimit dhe të Liçensimit nga Konfederatat e Azisë, Afrikës, Amerikës së Veriut dhe të Jugut, si dhe të FIFA-s. Shqipëria në një event të tillë me shumë rëndësi u përfaqësua nga Aldi Topçiu (Kryetar i Komisionit

te Liçensimit si dhe nga Eduard Gjini Menaxher i Liçensimit te FSHF-së. Ky seminar u ndal dhe trajtoi tema si:

- Struktura e re e organizimit te UEFA-s per Liçensimin
 - Hyrje në Qëndrën e Inteligjencës së UEFA-s
- Ndërsa në lidhje me vendimet e Liçensimit të Klubeve për vitin 2017, të gjithë anëtarët u njohën me një një paraqitje të përgjithshme mbi aktivitetet bazë, si dhe morën një përmbledhje të vendimeve të Liçensimit për vitin 2017. Po kështu në këtë seminar me shumë peshë, të gjithë përfaqësuesit e 55 anëtarëve të UEFA-s u ndalën edhe në trajtimin e çështjeve si:
- Investigimi i procesit te Monitorimit të Klubeve
 - Të ardhurat e përfituara nga Klubet nga transferimi i lojtarëve
 - Refuzimi i Liçensave nga Shoqatat anëtare dhe mënyra e kualifikimit të klubeve, të cilave i është dhënë Liçensa
 - Funkionimi i Departamentit të Liçensimit të UEFA-s

Në të gjitha diskutimet u tregua eksperiencia e secilës konfederatë në lidhje me Monitorimin dhe Proçesin e Liçensimit të Klubeve. Theksi i të gjitha diskutimeve u vu në proçesin e Monitorimit dhe Liçensimit te Klubeve, problemeve të Fair-Play financiar, plotësimit të të gjithë dokumentacionit të Liçensimit, si dhe të Paketave financiare në Afatet kohore të përcaktuara, nga ana e klubeve.



Energy for the future!



ENERGJIA E KOMBETARES TONE

W-Power ^{BOLV-OIL®}

- ✓ Djegje e pastër
- ✓ Eco-Friendly
- ✓ Jetëgjatësi
- ✓ Kilometra më shumë

We got the POWER ^{DIESEL}



Sponsor i Kombëtares Shqiptare të Futbollit





SAFET BERISHA

KAPITENI I MADH

nga **Triton KOKONA**

Në qoftëse do të kishte një shprehje që do të përmblihte karrierën e tij brilante, ajo do të ishte: I veçantë...

I veçantë në shumë aspekte të karrierës së tij jetëgjatë si me Partizanin, ashtu edhe me skuadrën tonë kombëtare. I veçantë për mënyrën e lojës që prodhoi, i veçantë për mënyrën inteligjente dhe elegante me të cilën luajti futboll. I veçantë, në kohën që jetoi, ku shumë gjëra edhe në futboll, mbetën të privuara. Bëhet fjalë për Safet Berishën!

Safet Berisha, ka lindur më 11 nëntor të viti 1949, në qytetin e Durrësit. Herët është dashuruar me futbollin dhe si shumë bashkëmoshatarë të tij, është përfshirë në magjinë e kësaj loje të bukur. Fillimet e tij i ka me Lokomotivën e Durrësit, luan mirë dhe bie në sy për forcën, elegancën dhe zgjuarsinë e tij.

Në fundin e viteve '60 aktivizohet me skuadrën e Partizanit. Me këtë skuadër ka patur një karrierë të gjatë dhe të suksesshme. Me këtë skuadër ai është shpallur kampion kombëtar në vitet 1971, 1979 dhe 1981. Është fitues i Kupës së Republikës në vitin 1980. Me Partizanin, atë e lidh edhe një rezultat historik, i arritur nga kjo skuadër, siç është fitorja e Kupës Ballkanike. Me kalimin e viteve ai nisi të shndërrohet, në një pikë referimi e skuadrës së kuqe, duke qenë për shumë vite edhe kapiten i saj.

Ndonëse ka luajtur në një periudhë të vështirë për futbollin shqiptar, veçanërisht sa i takon ballafaqimeve ndërkombëtare, për shkak të një vetëizolimi total dhe absurd, Safeti nuk ka munguar në ballafaqimet historike ndërkombëtare të skuadrave shqiptare.

Në vitin 1978, Vllaznia e Shkodrës merr pjesë në Kupën e Kampioneve. Berisha aktivizohet me Vllazninë, si përforcim kundër kundërshtarit të njohur Austria e Vjenës.

"Përforcimi", kjo praktikë e njohur dhe origjinale e klubeve shqiptare (skuadrat

pjesëmarrëse në Kupat e Europës, në futboll volejbolli dhe basketboll, aktivizonin edhe lojtarët më të mirë të klubeve të tjera për të bërë një paraqitje sa më të mirë) i dha mundësinë mbrojtësit të njohur që të luante të dyja ndeshjet kundër austriakëve. Në Shkodër, kur Vllaznia fitoi 2-0 dhe në Vjenë ku shkodranët u përmbysën 4-1.

Një vit më pas, është përsëri në Kupën e Kampioneve por këtë radhë me Partizanin e tij, me të cilin ishte shpallur kampion kombëtar. Kundërshtari ishte një tjetër skuadër e madhe dhe me emër në futbollin botëror. Selltiku i Gllazgout. Partizani me golin emblemik të shënuar nga Agim Murati. Në ndeshjen e kthimit në Skoci, Partizani mundet 1-4, duke u eliminuar. Në vitin pasardhës, skuadra e kuqe merr pjesë në Kupën e Kupave, si fituese e kupës së Republikës. Dy përballjet emocionuese, kundër suedezëve të Malmoes, përfundojnë: 1-0 në Suedi dhe barazim i bardhë pa gola në Tiranë. Kapiten i Partizanit si gjithnjë është Safet Berisha. Një vit më pas përtë katërtën herë Safet Berisha është në kupat europiane. Përsëri me Partizanin e tij dhe kundër një kundërshtari të njohur si Austria e Vjenës. Ndeshjen e parë e humbet në Vjenë 3-1 dhe ndeshjen e dytë e fiton në Tiranë me rezultatin 1-0 me gol të shënuar nga Haxhi Ballgjini.

Sa i takon ekipit kombëtar, Berisha mund të konsiderohet një rast i veçantë. Ndeshjen e tij të parë me kombëtaren Safet Berisha e ka luajtur më 13 dhjetor të vitit 1970 në miqësoren kundër Turqisë. Ishte ndeshja numër 40 e kombëtares tonë. Mungon në ndeshjen pasardhëse, por rikthehet në kombëtare në ndeshjen nr.42 kundër Polonisë për eliminatoret e Kampionatit Europian. Nga ndeshja pasardhëse kundër Gjermanisë Perëndimore më 12 qershor 1972 në Karlsruhe, e deri në 1981 ai ka qenë i padiskutueshëm në formacionin

bazë të ekipit kombëtar. Mëkat që një gjigand i përmasave të tilla luajti në një periudhë shumë të vështirë për futbollin shqiptar. Ishte një kohë kur në Shqipëri, jepeshin urdhra absurdë, për të mos lejuar kombëtaren shqiptare të futbollit

të mernte pjesë në eliminatoret e Kampionateve Europiane të viteve 1976 dhe 1980, si dhe ato të Botërorit të vitit 1978. Nga nëntori i vitit 1973 e deri në vitin 1980, kombëtarja shqiptare e futbollit zhvilloi vetëm dy takime miqësore me Kinën dhe Algjerinë. Safet Berisha luajti 20 ndeshje me kombëtaren. Takimi i fundit ka qenë kundër Gjermanisë në Dortmund. Ai u largua nga futbollit në moshën 33 vjeçare.

Ai ndërroi jetë në moshën 67 vjeçare. La pas, një kontribut të vyer për futbollin shqiptar, i cili tashmë i përket historisë. Ai do të jetë gjithmonë në kujtimet tona, i qetë, korrekt dhe i respektuar nga të gjithë.

Në mbrëmjen e fundvitit të kaluar, Federata e Futbollit, me vendim të Komitetit Ekzekutiv, e dekoroi Safet Berishën me titullin e lartë "Nderi i Futbollit Shqiptar" me motivacionin:

"Me një kontribut të shquar në futbollin shqiptar të viteve 1970-1980. Si kapiten i Partizanit ka arritur disa rezultate të rëndësishme në karrierën e tij, si kampion kombëtar, fitues i Kupës së Republikës dhe fitues i Kupës Ballkanike. Kapiten i skuadrës kombëtare dhe lojtar i padiskutueshëm i formacionit të saj".

"Safet Berisha, ishte dhe do të mbetet një kapiten i madh i futbollit shqiptar. Kujtimi i tij, do të jetë gjithmonë i nderuar dhe i vlerësuar nga i gjithë komuniteti i futbollit, nga familjarët, shokët, miqtë dhe dashamirësit e shumtë.

Ai tashmë, prehet në parajsë dhe jeton në kujtimet tona, si një pjesë e rëndësishme e historisë së futbollit shqiptar. Ndërsa ne ndjehemi edhe më të plotësuar tek nderojmë figura të tilla"- theksoi në ceremoninë e organizuar nga FSHF për 1 vjetorin e vdekjes, Presidenti Armand Duka.





THE BEST CLUBS WEAR MACRON
WHY DON'T YOU?
 VISIT YOUR LOCAL STORE FOR A QUOTATION



www.macron.com

SEE WHO ELSE HAS CHOSEN MACRON



RING CENTER TIRANA - Zogu i zi TIRANA - 1001 Albania
 Tel: +35 5682006747 - tirana@macronstore.com

macronstore
 Tirana



FEDERATA SHQIPTARE E FUTBOLLIT



REZULTATET LIVE NË ÇDO KOHË



i INFORMACIONE




SKEDAT E NDESHJEVE



KALENDARI



MEDIA GALLERY



FSHF TV



SHKARKONI NË SMARTFONIN TUAJ APLIKACIONIN ZYRTAR TË FSHF



EQUAL # GAME

'EVERYONE SHOULD BE ABLE
TO ENJOY FOOTBALL. NO MATTER WHO
YOU ARE, WHERE YOU'RE FROM
OR HOW YOU PLAY.'



RESPECT

EQUALGAME.COM